



Buletini i Austria Praemix

Kategoria: Shpendë

Përmbajtja:

1. KONCEPTE TË TË USHQYERIT TËPULAVE	3
2. CILËSIA E VEZËVE – TË USHQYERIT EPULAVE	5
3. TË USHQYERIT NË MËNYRË EFIKASE PËR PULAT PËR VEZË	7
4. LËNDËT USHQYESE QË NEVOJITEN PËR PULAT PËR VEZË	9
5. METODAT E DUHURA PËR NJË VENTILIMTË MIRË NË PULARI	12
6. NDIKIMI I TEMPERATURAVE TË LARTATE SHPENDËT.....	14
8. PULAT PËR VEZË: TË USHQYERITSIPAS KËRKESAVE TË SHPENDIT	17
9. RËNDËSIA E UNIFORMITETIT TE PULAT	19
10. IMPAKTI I SALMONELËS TE SHPENDËT	20
11. SHMANGIA E DERMATITIT TE KËMBËT E PULAVE	21
12. MËNYRA EFEKTIVE PËR SHMANGIEN E STRESIT TE PULAT	23
13. MASAT PËR NJË CILËSI OPTIMALE TË GUASKËS SË VEZËS.....	25
14. PËRPARËSITË E PËRDORIMIT TË BONVITAL.....	27
15. MENAXHIMI I SHTROJËS- PËRGATITJA EDUHUR PËR VJESHTËN!	29
16. TË USHQYERIT E PULAVE PËR VEZË	31
17. DEVIJIMET NGA SJELLJA NORMALE E SHPENDËVE	34
18. MYK NË VEZËT E FRESKËTA.....	36
19. MATJA E DHOMËS SË AJRIT TË VEZËS	37
20. VEZËT E FSHATIT JANË NË MODË	39
21. REZISTENCA NDAJ ANTIBIOTIKËVE	41
22. MASAT PARANDALUESE KUNDËR INSEKTEVE NË STALLË.....	45
23. BLEGTORIA E ORIENTUAR DREJT PERFORMANCËS FILLON ME NJË HIGJIENË TË QËNDRUESHME TË STALLËS	47
24. SCHAUMACID NË USHQIMIN E SHPENDËVE –PERFORMANCË MË E LARTË.....	50
25. CILËSIA E LARTË E UJIT TË PIJSHËM REZULTON EFEKTIVE.....	52
26. GJELA DETI TË SHËNDETSHËM DHE TË FUQISHËM - SUKSES I GARANTUAR ME PRODUKTET SCHAUMANN!	

1. KONCEPTE TË TË USHQYERIT TËPULAVE

Përpunuar nga Kristian Maka



Pulat për vezë

Gjatë fazës së rritjes dhe me vonë, gjatë asaj të pjelljes së vezëve, kërkesat e pulave për lëndë ushqyese ndryshojnë vazhdimisht. Kjo, si pasojë e nevojës së përdorimit të llojeve të ndryshme të ushqimit, në varësi të stadi të zhvillimit dhe performancës së shpendit - të ushqyerit me faza.

Të ushqyerit është baza thelbësore për rritjen normale të shpendëve nga zogj në zoga e deri te pulat e rritura për vezë. Koncepti i të ushqyerit duhet të bazohet në kërkesat e shpendit. Kërkesa për lëndë ushqyese varet gjithashtu nga ndryshimet në menaxhimin e fermave të pulave, nga faktorët mjedisorë, si dhe veçanërisht në format alternative të mbarështimit.

Konceptimi i llojeve individuale të ushqimit gjatë të ushqyerit me faza dhe përzgjedhja e lëndëve të para si drithërat, bartësit e proteinave, yndyrat dhe vajrat bimore, mineralet dhe aditivët duhet të përcaktohen rreptësisht në bazë të kërkesave të kafshëve për lëndë ushqyese.

Zogjtë/Zogat

Baza për fazën e shtrimit dhe më vonë të performancës së pulave vendoset që në fillim. Kur zogat kalojnë në kafaze (bateri), ato duhet karakterizohen veçanërisht nga një peshë optimale e trupi. Kjo duhet të jetë të paktën sa pesha e synuar e racës përkatëse, akoma më mire nëse, gjatë kalimit të zogave nëpër bateri, pesha është 50g deri në 100 g më e lartë.

Ushqimi për fazën e para-prodhimit/para-shtrimit

Pak para se të fillojë pjellja e vezëve, veçanërisht në sistemet alternative (në bateri), pulat duhet të përshtaten në kohën e duhur me mjedisin e ri. Prandaj është e dobishme zhvendosja e zogave në shtëpitë e pjelljes në një moshë të hershme, 16 deri në 17 javë.

Në këtë moshë, pulat ende nuk janë rritur plotësisht fiziologjikisht dhe për këtë arsye nuk duhet t'u jepet ushqim i fazës së pjelljes, pasi për shkak të përmbajtjes së lartë të kalciumit kjo "i shtyn" pulat shumë herët për të filluar pjelljen e vezëve. Në moshën 16 deri në 18 javë ose 17 deri në 19 javë, pulat në bateri marrin ende ushqimin e zogave dhe jo të pulës së vezës.

Në përgjithësi, duhet të shmangen zogat që janë shumë të lehta. Në asnjë moment gjatë periudhës së pjelljes këto zoga nuk tregojnë performancë normale, në përputhje me përbërjen e tyre gjenetike. Zogat nuk duhet të jenë me një peshë të lartë trupore. Përdorimi i ushqimit të zogave nga java e 9-të deri në 16-të e jetës është absolutisht i nevojshëm për të arritur një kapacitet të mirë të marrjes së ushqimit. Zogat duhet të ushqehen në bazë të kërkesave për secilën fazë të jetës dhe mënyrës së mbarështimit.

Sistemet e mbarështimit- Dysheme dhe Bateri

Për pulat e reja që rriten në sistem dysheme ose sistem bateri rekomandohet veçanërisht përdorimi i një ushqimi për fazën e para-prodhimit. Ushqimi fillestar ka rreth dyfishin e përmbajtjes së kalciumit, si dhe përmbajtje më të lartë të proteinave dhe aminoacideve, krahasuar me ushqimin e zogave. Prandaj, është shumë e rëndësishme që ky ushqim të përdoret për rreth 14 ditë para fillimit të planifikuar të pjelljes së vezëve - nëse kaloni herët në fazën e pjelljes, është e detyrueshme.

Ky ushqim përmirëson uniformitetin e tufës duke i lejuar shpendëve të rinj të maturohen, të marrin kalcium të mjaftueshëm për formimin e lëvozhgave të vezëve të para dhe duke siguruar ushqim më të mirë për shpendët me maturim të vonë. Periudha kohore e përdorimit të ushqimit për fazën e para-prodhimit/ para-shtrimit dhe koha optimale për kalimin në bateri duhet të koordinohen me mbarështuesin e pulave.

Zhvendosja e pulave përfaqëson një barrë të veçantë për shpendët. Kalimi në fazën e fillimit të pjelljes përfaqëson gjithashtu një ndryshim themelor në proceset fiziologjike. Organizmi duhet të përshtatet nga faza e rritjes dhe e formimit të trupit në fazën e fillimit të aktivitetit të pjelljes së vezëve, në të njëjtën kohë pulat nuk janë rritur ende plotësisht.

Gjithashtu, në këtë fazë ndryshimet hormonale ndikojnë në marrjen e ushqimit. Si rezultat, marrja e ushqimit në këtë fazë shpesh është më pak se 100 g për kafshë/ në ditë. Duke konsideruar kërkesat e pulës për lëndë ushqyese si dhe përmbajtjen e energjisë së ushqimit të përdorur, kjo sasi është absolutisht shumë pak. Në këtë fazë, duhet bërë çdo përpjekje për të rritur shpejt marrjen e ushqimit deri në 115 g në ditë, të ushqyerit disa herë në ditë, të ushqyerit në lugun bosh, duke ofruar ushqim me strukturë optimale dhe sisteme të të ushqyerit të mirë ndriçuara.

Dendësia e lëndëve ushqyese

Për të mbështetur marrjen e lëndëve ushqyese, është parë e arsyeshme, që pulave t'u ofrohet ushqim me një densitet më të lartë të lëndëve ushqyese (11,6 - 11,8 MJ/kg), kryesisht me një përmbajtje të rritur të aminoacideve. Nëse pula është e pafurnizuar me lëndë ushqyese gjatë fillimit të pjelljes, kjo rrezikon suksesin e të gjithë periudhës së pjelljes dhe çon në humbje të pakthyeshme në performancë. Por kujdes: Shtimi i ushqimit me një përmbajtje kalciumi prej më shumë se 3% nuk duhet të ofrohet shumë herët. Në koordinim me fermerin, rekomandohet përdorimi i ushqimit për fazën e para-prodhimit. Në fillim të periudhës së pjelljes, pulat duhet të arrijnë shpejt në nivele të mjaftueshme ushqimi. Mungesa e lëndëve ushqyese në fillim të pjelljes e rëndon metabolizmin e kafshëve dhe mund të kontribuojë në shfaqjen e sindromës së mëlçisë së dhjamosur. Vetëm kur pjelljet në tufë kanë arritur në rreth 5%, fillon kalimi në një ushqim starter me cilësi të lartë.

Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

2. CILËSIA E VEZËVE – TË USHQYERIT EPULAVE

Përpunuar nga Dardan Grajçevci

Ferma e shpendëve e familjes Möhler në Baden-Württemberg mbarështoi me sukses pula prej dy gjeneratash. 17.000 pula për vezë u ushqyen gjatë gjithë vitit me përzierje drithi Tri-Ovital. Një koncept që të shpërblen.

Programi Ovital ofron një sërë produktesh që mund të përdoren në kushte të ndryshme në të ushqyerit e pulave për vezë. Përveç Ovital Intensiv, kërkimet shkencore të Schaumann kanë zhvilluar edhe produktin Tri-Ovital, i cili redukton sekretimin e azotit dhe fosforit, si pasojë e shtimit të synuar të aminoacideve dhe fitazës. Tri-Ovital Mais është gjithashtu i përshtatur saktësisht për përdorimin e misrit.

"Ushqimi e bën vezën" - një koncept i jetuar në fermën Möhler. Shija e mirë vjen nga ushqyerja e shëndetshme.

17,000 pula për vezë u mbajtën në dy sisteme të ndryshme. 12,000 pula qëndruan në një sistem konvencional Salmet-me kafaz. 5,000 pula u vendosën në një sistem Salmet-pa kafaz (funksional në nëntor 2003). Ky është vendi ku vendosen pulat në javën e 16-të të jetës.

Pulat e reja si ushqim paraprak konsumuan një përzierje Ovital-A. Kjo përzierje speciale e rritjes kontrollon peshën e gjallë të pulave të reja dhe optimizon madhësinë e vezëve në fillim të periudhës së shtrimit. Përveç përzierjes Ovital-A, ferma Möhler përdori edhe përzierjen Tri-Ovital starter, si dhe përzierjet për fazën 1 dhe 2. Përbërësit më të rëndësishëm të këtyre përzierjeve janë paraqitur në tabelën 1 dhe 2.

Caktimi i përzierjeve individuale është paraqitur në figurën 3 bazuar në një vlerësim të pjesshëm të 6000 pulave për vezë.


Fig. 1: Përbërja e përzierjeve të ushqimit

FM%	Ushqim para fazës së shtrimit	Starter	Faza I	Faza II
Grurë	63.5	39.5	46	42.5
Misër kokërr	-	20	14	14
Elb	10	5	7	12
Miell soje. 46 RP	19	22	20	18
Karbonati i gëlqeres	3.5	8	8.5	9.5
Vaj soje	1	3.5	2.5	2

Fig. 2: Përbërësit e përzierjeve të ushqimit

Përbërësit	Ushqim para fazës së shtrimit	Starter	Faza I	Faza II
Substancë e thatë g/kg	888	894	893	894
Proteinë e papërpunuar g	177	175	172	162
Yndyrë të papërpunuar g	26	54	43	38
Fibër e papërpunuar g	32	30	30	31
Hi i papërpunuar g	86	118	123	132
ME Shpendë MJ	11.5	11.84	11.5	11.24
Calcium g	21.5	35.1	37	40.8
Fosfor g	6	4.2	4.2	4.1
Natrium g	1.7	1.7	1.7	1.7
Magnez g	1.5	1.5	1.5	1.5
Lysin g	8.12	8.72	8.27	7.77
Methionin g	3.65	4.12	4.04	3.95
Vitamin A IE	12000	10000	10000	10000
Vitamin D IE	1950	2500	2500	2500
Vitamin E IE	20	20	20	20
Fitaza Mg	-	+++	+++	+++

Fig. 3: Performanca e 6000 pulave



Meqenëse konsumatorët kërkojnë vetëm vezë XL dhe L, madhësia e dëshiruar e vezëve arrihet në masën 92% me përdorimin e starterit, për gati tre muaj. Kjo pasohet nga përdorimi i ushqimit të shtrimit të fazës 1 ose të fazës II. Periudha e dytë e shtrimit zgjat edhe 6 muaj të tjerë. Klasifikimi i madhësisë së vezëve luan një rol kyç në tregtinë dhe marketingun e vezëve.

Nuk ka dallim në performancë ndërmjet formave të ndryshme të rritjes së pulave. Madje, lëvozhgat e vezëve nga pulat e rritura në sistemin Salmet- pa kafaz janë më të dobëta.

Norma e lëvozhgave të thyera më pak se 0,5%, tregon për cilësinë e ushqimit të përdorur.

Konceptet e ushqyerjes si dhe pyetjet e vazhdueshme rreth përmirësimit të performancës diskutohen shpesh nga menaxheri i fermës Möhler me konsulentët e kompanisë Schaumann, që konvertojnë rezultatet në koncepte të reja përzierjeje. Rezultati tregon se përdorimi i drithit, i plotësuar me ushqimin e duhur mineral nga linja Ovalit, çon në një bashkëpunim të suksesshëm.

Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

3. TË USHQYERIT NË MËNYRË EFIKASE PËR PULAT PËR VEZË

Përpunuar nga Kristian Maka

Me rritjen e pjellorisë dhe ndryshimin e kushteve të mbarështimit, ka ndryshuar ndjeshëm edhe ushqimi i pulave për vezë. Ky zhvillim kërkon përshtatje të vazhdueshme përgjatë të gjithë zinxhirit prodhues.

Falë menaxhimit, mbarështimit dhe të ushqyerit të suksesshëm në dhjetëvjeçarin e fundit, pulat e sotme mund të pjellin më shumë vezë me një konsum më të vogël të lëndëve ushqyese. Ky progres është realizuar në përputhje me kuadrin ligjor për të drejtat e kafshëve. Nëse një pule pas luftës së dytë botërore kishte nevojë për 200 g ushqim për vezë, sot kjo sasi është ndjeshëm më e ulët, rreth 135 g. Nga ana tjetër kanë ndryshuar edhe kërkesat ushqimore si dhe përqëndrimi i lëndëve ushqyese në racionin ushqimor.

Ushqimi për pula në ditët e sotme përmban më shumë lëndë shtesë (enzima, probiotikë), të cilat përmirësojnë tretjen dhe rrisin prodhimtarinë e shpendëve. Tek këto lëndë shtesë bëjnë pjesë përshembull fitaza (enzimë), e cila bën të mundur shpërbërjen e fosforit në ushqim. Një grup tjetër janë edhe aminoacidet, të cilat përdoren në mënyrë specifike për nevoja të shpendit dhe mund të zëvendësojnë një pjesë të burimeve të proteinave bimore si përshembull soja. Me rritjen e prodhimtarisë shtohen kërkesat për higjienën ushqimore. Përpunimi termik “vret” patogjenët e rrezikshëm si Salmonella dhe ul ngarkesën bakteriale. Për mbajtjen në një nivel konstant të mykotoksinave (rezistente ndaj nxehtësisë), nevojiten kontrole shtesë dhe të vazhdueshme të furnizimeve me lëndë të para. Masat për ruajtjen e higjienës në ushqim nuk duhet të përqëndrohen vetëm në impiantin e përzierjes së ushqimit, por është gjithashtu hambarët e ushqimit duhet të boshatisen plotësisht në mënyrë që të sigurohet dezinfektimi dhe sterilizimi i komplet ambientit të brendshëm.

Jo vetëm ushqimi por edhe teknika e të ushqyerit është zhvilluar shumë. Të ushqyerit me faza është tashmë një realitet konkret në çdo pulari. Pulat për vezë kanë kërkesa të larta për rritje dhe prodhimtari.

Duke qenë se shpendët marrin më pak ushqim, duhet që ky ushqim të përmbajë më shumë energji dhe proteina. Në varësi të prodhimtarisë, nevoja energjitike ditore bie duke filluar nga java e 50-të në të 55-tën. Nevoja për proteinë fillon të bjerë edhe më herët. Si pasojë e uljes së përthithjes së kalciumit në sistemin tretës, në fazën e dytë të prodhimtarisë është e rëndësishme një përmbajtje më e lartë kalciumi në raportin ushqimor. Vetëm nëpërmjet të ushqyerit me faza është i mundur një mbulim optimal i nevojave të ndryshueshme të pulave, gjë që sjell një gjendje shëndetsore më të mirë dhe prodhimtari më të lartë.

Sektori i ushqimit bio përbën sfidën më të madhe. Lëndët shtesë të përdorura në ushqim si enzimat dhe aminoacidet për shkak të proceseve të tyre përpunuese nuk janë konform udhëzimeve ligjore bio.

Pulat bio janë të njëjta ose shumë të ngjashme gjenetikisht me hibridet që përdoren zakonisht. Ato mund të arrijnë të njëjtin potencial prodhimtarie nëse ushqimi dhe menaxhimi bëhet sic duhet. Në mënyrë që pulat bio të pëthithin mjaftueshëm lëndë ushqyese, ekziston tendenca që ushqimi të ketë një përmbajtje më të lartë lëndësh ushqyese. Në këtë kontekst përmbajtja e proteinës është gjithmonë e rëndësishme. Rëndësi i duhet dhënë nevojës për metioninë (aminoacid esencial). Mbidozimi i proteinës është shpesh i dëmshëm për shpendin sepse shpërbërja e proteinës sjell mbingarkesë në mëlcë dhe në veshka. Për këtë nevojitet një konsum më i lartë uji. Një mbidozim me proteinë nuk përbën humbje vetëm për shpendin, por është një faktor më shumë në ndotjen e ajrit brenda dhe jashtë stallës. Ushqimi duhet përgatitur në mënyrë të tillë që të përmbajë elementet ushqimor në raport të drejtë, të leverdisshëm dhe jo thjesht në sasi të mëdha. Në këtë mënyrë mund të prodhohen përzierje ushqimore të plota dhe të balancuara.

Perspektivat

Në Hollandë një prodhues ushqimi ka zhvilluar një lloj ushqimi të lëngshëm. Pulat ushqehen me një masë të ngjashme me brumin. Inovacionet janë të rralla, sepse kërkojnë investime të mëdha në pulari dhe nuk janë lehtësisht të zbatueshme. Pularitë bëhen më të mëdha gjë që e bën edhe më të thjeshtë përdorimin e ushqimeve specifike. Falë numrit më të lartë të shpendëve rritet dhe sasia e furnizimit me ushqim, kjo e bën më të leverdisshëm ushqimin të ndarë me faza.

Ndërtimi i paisjeve të dozimit (dozatronëve) bën të mundur përdorimin e saktë të produkteve speciale gjatë fazave kritike, si dhënien e kalciumit. Në përfundim gjenden edhe lëndë të tjera shtesë me prejardhje bimore ose shtazore, të cilat mund të ndikojnë pozitivisht në sistemin imunitar, tretjen, florën bakteriale të zorrëve dhe metabolizmin e shpendëve.

Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

4. LËNDËT USHQYESE QË NEVOJITEN PËR PULAT PËR VEZË

Përpunuar nga Kristian Maka

Për të arritur një performancë të lartë biologjike të pulave për vezë, ato duhet të furnizohen me të gjithë lëndët ushqyese të nevojshme, në sasi të duhura dhe sipas nevojave specifike. Lëndët ushqyese dhe përbërësit aktivë të nevojshëm ndryshojnë sipas kërkesave specifike si p.sh. lloji i mbarështimit, formimi i puplave, prodhimi masiv i vezëve. Kërkesa për lëndë ushqyese është në thelb e varur nga performanca biologjike, peshë trupore dhe matet duke përdorur derivimin faktorial.

Kërkesa totale për lëndë ushqyese e pulës është shuma e kërkesave për mirëmbajtje dhe performancë:

- Kërkesat e mirëmbajtjes (nevojën për energji dhe lëndë ushqyese): Kërkesat për marrjen e ushqimit, frymëmarrjen, rregullimin e temperaturës.
- Kërkesat e performances: Kërkesat për formimin e vezëve, peshën e gjallë dhe formimin e puplave të reja.

Energjia dhe dendësia e lëndëve ushqyese në ushqim si dhe marrja e ushqimit janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën. Dendësia e energjisë/lëndëve ushqyese të ushqimit përcaktohet duke marrë parasysh kërkesën e shpendit për ushqim. Të ashtuquajturat rekomandime të furnizimit për nivelet e lëndëve ushqyese janë shumë të rëndësishme.

Në praktikë, krahas rekomandimeve shkencore, përdoren edhe specifikime menaxhimi nga kompani mbarështuese për pulat e tyre hibride. Meqenëse përzjerjet e ushqimit të thatë përdoren pothuajse gjithmonë në mbarështimin komercial të pulave për vezë, përmbajtja e energjisë dhe lëndëve ushqyese të përzjerjeve të ushqimit zakonisht është në një përmbajtje prej 88% lëndë e thatë.

Formula e mëposhtme (1999) përdoret për të llogaritur kërkesën totale për energji të pulës për vezë:

$$ME (kj/d) = (480 + (15 - UT) \times 7) \times LM_{0,75} + 23 LMZ + 9.6 \times EM$$

UT = Temperatura e ambientit °C

LM 0.75 = Biomasa metabolike

(kg/LH) LMZ = Shtimi i peshës së

gjallë (g/LH/Tag) EM = Peshë ditore e

vezëve (g)

Formula tregon se kërkesa për mirëmbajtje varet nga madhësia e trupit, e cila vlerësohet nga i ashtuquajtur

ekuacion Kleiber duke përdorur peshën trupore 0.75. Temperaturat e ambientit nën 15°C rrisin nevojën për mirëmbajtje. Kur llogaritet kërkesa totale, për shembull në një tufë me një prodhim ditor të vezëve në masë prej 60 g afërsisht 60% llogaritet nga pjesa e mirëmbajtjes dhe 40% nga kërkesa për performancën. Masa e gjallë ka ndikim dominues në kërkesat e mirëmbajtjes.

Në momentin e zhvendosjes së pulave në kafaze (bateri), ato nuk e kanë arritur ende peshën e tyre përfundimtare të gjallë. Masa e gjallë në javën e 18-të të jetës është përafërsisht 1,250-1,350 g për pulat e bardha dhe përafërsisht 1,450-1,550 g për pulat kafe; në javën e 72-të të jetës përafërsisht 1800 g/2000 g. Gjatë llogaritjes së kërkesës për ushqim merret parasysh rritja e peshës trupore deri në javën e 32-të të jetës. Rritja në rënie e peshës trupore nga java e 33-të e jetës nuk merret parasysh, sepse ajo zakonisht mbulohet nga kufijtë e sigurisë.

Kjo formulë e llogaritjes së energjisë zbatohet vetëm në kushte të mire definuara. Duke marrë parasysh ushqyerjen praktike të pulave, si të tilla konsiderohen mbajtja e pulave në kafaze konvencionale dhe prania e puplave të plota.

Për shkak të ndarjes së zonave funksionale dhe hapësirës shtesë, pulat në sisteme mbarështimi alternative lëvizin shumë më tepër sesa ato në kafaz/rritje në tufa të vogla, të cilat kryejnë me pak lëvizje. Lëvizja shtesë kërkon energji shtesë. Për këtë qëllim, GfE (1999) supozon një kërkesë mirëmbajtjeje 10% më e lartë për sisteme mbarështimi dysheme dhe 15% më e lartë për pulat e rritura në gjendje të lirë. Duhet theksuar se shtesat prej 10 ose 15% kanë të bëjnë me kërkesën për mirëmbajtje dhe jo me kërkesën totale. Humbjet e puplave gjithashtu tregojnë një kërkesë të shtuar për energji (tabela 1).

Sistemi i mbarështimit, madhësia e trupit, niveli i performancës, gjendja e puplave dhe, nëse është e aplikueshme, temperatura e stallës kanë një ndikim të rëndësishëm në kërkesën për energji (tabela).

Tabela 1: Kërkesa relative për energji (%) e pulave për vezë në varësi të sistemit të mbarështimit, prodhimin masiv të vezëve, peshës trupore dhe gjendjes së puplave.


	Rritja në tufa të vogla	Sisteme dysheme	Rritja në gjendje të lirë
Pesha ditore e vezës: 55 g, Pesha e trupit: 1.800 g Nuk ka humbje të puplave, Temperatura: > 15 °C	100 %	106 %	109 %
Pesha ditore e vezës: 55 g, Pesha e trupit: 1.800 g 30% humbje të puplave, Temperatura: > 15 °C	107 %	114 %	117 %
Pesha ditore e vezës: 60 g, Pesha e trupit: 2.000 g 30% humbje të puplave, Temperatura: > 13 °C	118 %	124 %	128 %

Në lidhje me densitetin e energjisë në ushqimin konvencional të pulave për vezë, mund të bëhen rekomandimet praktike të mëposhtme:

— 11,4 MJ ME/kg: sasia standarde e energjisë së nevojshme, në fillim të fazës së shtrimit ose prodhimit vetëm nëse konsumi i ushqimit rritet shpejt në > 120 g/pulë/ditë

— 11,6 MJ ME: Përdoret në fillim të fazes së prodhimit për të arritur një furnizim të mjaftueshëm me energji dhe lëndë ushqyese për një konsum ditor të ushqimit më pak se 110 g/pulë. Pas javës së 26-të të jetës, mund të bëhet kalimi në ushqimin 11,4 MJ ME nëse konsumi i ushqimit është mjaftueshëm i lartë. Përndryshe, dendësia e energjisë mund të mbahet në 11.6 MJ ME/kg deri pas pikut të shtrimit. Krahasuar me ushqimin 11,4 MJ ME, ushqimet me 11,6 MJ ME duhet gjithashtu të kenë të rregulluar nivelet e tyre ushqyese (aminoacide, minerale, etj.) (nivele më të larta).

Vlerësimi i energjisë për shpendët bazohet në energjinë e metabolizueshme (ME). Kjo do të thotë se informacioni mbi përmbajtjen e energjisë së ushqimeve dhe përzierjeve jepet në MJ ME. Fazat individuale të degradimit të energjisë së ushqimit tregohen në figurën më poshtë.



VLERËSIMI I ENERGJISË TE SHPENDËT

Përmbajtja e energjisë llogaritet në bazë të niveleve të përcaktuara analitikisht të proteinave të papërpunuara, yndyrave të papërpunuara, niseshtës dhe sheqerit. Përmbajtja energjetike e ushqimit për pulat për vezë përcaktohet nga një laborator, këta katër përbërës duhet të ekzaminohen gjithmonë.

Formula e mëposhtme e vlerësimit e WPSA (1984) përdoret për të llogaritur përmbajtjen e energjisë së metabolizueshme në ushqimin e kafshëve:

$$\text{MJ/kg} = 0,01551 * \text{g Proteinë e papërpunuar} + 0,03431 * \text{g Yndyrë e papërpunuar} + 0,01669 * \text{g Niseshte} + 0,01301 * \text{g Sheqer}$$

Kërkesa për energji përcaktohet nga lloji i sitemit të mbarështimit, madhësia e trupit, niveli i performancës, gjendja e puplave dhe, nëse është e nevojshme, edhe temperatura e stallës. Aktiviteti i lartë fizik në sistemet mbarështimi dysheme si dhe ato në gjendje të lirë rrisin nevojën për mirëmbajtje me 10 ose 15% në krahasim me ritjen e pulave në tufa të vogla. Informacioni mbi përmbajtjen energjetike të shpendëve jepet në energjinë e metabolizueshme (ME). Përqendrimet e energjisë në ushqimin konvencional të pulave për vezë janë në nivelin 11,4 deri në 11,6 MJ ME për kg ushqim.

Për më shumë informacion:



Q F Qendra e Formimit
P B Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

5. METODAT E DUHURA PËR NJË VENTILIM TË MIRË NË PULARI

Përpunuar nga Kristian Maka

Studimet tregojnë se në mbarështimin e shpendëve ka një kërkesë të mëdha për energji.

Eksperti i Dhomës së Bujqësisë, GOTTFRIED ETLINGER zbulon se çfarë duhet të keni kujdes nëse doni të ajrosni në mënyrë efektive pularinë si dhe të keni përfitime ekonomike.

Normat e rregulluara të ventilimit ndihmojnë në kursimin e energjisë elektrike: Energjia elektrike mund të kursehet nëse shpejtësia e ajrit nuk është më e lartë se sa kërkohet dhe nëse janë instaluar sisteme ventilimi me kërkesa minimale energjie. Në varësi të sistemit të ventilimit dhe rezistencës së ajrit, energjia e nevojshme për të lëvizur 1000 m³ ajër, varion nga 30 në 120 wat orë për 1000 m³ ajër.



Përqëndrimi i CO2 në ajër

Normat e ventilimit varen nga disa kushte. Një parametër i rëndësishëm në mbarështimin e shpendëve është përqëndrimi i CO2 në ambientin e brendshëm. Nuk duhet të kalojë 3500 ppm ose 0.35% në vëllim. Rekomandohen përqëndrime prej rreth 2000 ppm. Ky kusht është vendimtar nëse diferenca e temperaturës midis ajrit brenda dhe ajrit jashtë është e madhe, pra më shumë se 20 °C. Kjo ndodh zakonisht në dimër te pulat e majmërisë. Në momentin që diferenca e temperaturës zvogëlohet, norma minimale e ventilimit zakonisht nuk është më e mjaftueshme dhe duhet të rritet në mënyrë që lagështia relative në stallë të mos rritet shumë.

Temperaturë e jashtme e lartë

Kur temperaturat e jashtme janë të larta, për të kufizuar rritjen e temperaturës në ambientin e brendshëm kërkohen vëllime edhe më të larta të ajrit. Në hapësirat

e pulave për vezë, raporti ndërmjet normës minimale dhe maksimale të ventilimit qëndron në kufi. Norma e ventilimit, sipas DIN 18910, është rreth 1:6. Në hapësirat e pulave të majmërisë, ky raport mund të jetë shumë i madh për shkak të rritjes së peshës së shpendëve. Norma e ventilimit prej 1:6 mund të mbulohet relativisht lehtë duke kontrolluar shpejtësinë e ventilatorëve individualë. Për diapazon më të madh të kontrollit, preferohet që aktivizimi i ventilatorëve të bëhet në grupe.

Balanca

Sigurimi në çdo kohë i normës së duhur të ventilimit është shumë i rëndësishëm për konsumin e energjisë. Nëse normat e ventilimit janë shumë të larta, ventilatorët do të konsumojnë shumë energji elektrike dhe nxehtësia e vlefshme do të shpërdorohet, pra pularitë në dimër duhet të ngrohen.

Kujdes nga rezistenca e ajrit

Shpesh nuk dihet saktësisht sasia minimale e kërkuar e ajrit dhe për këte arsye hasen probleme me kontrollin e sistemit të ventilimit, sepse shpejtësia e ventilimit varet nga rezistenca e ajrit. Rezistenca e ajrit ndryshon për shkak të efekteve të erës ose nga papastërtisë. Këto luhatje mund të merren parasysh duke lidhur një ventilator matës në rrjedhën e sipërme. Norma e ajrit që kërkohet për shpendët shpesh duhet të futet manualisht, madje edhe kur ka ventilator matës.

Ventilimi i kontrolluar me CO2

Kjo teknikë rregullon vazhdimisht dhe automatikisht shpejtësinë e ajrit sipas nevojave reale, të cilat varen nga popullata e shpendëve dhe aktiviteti i tyre. Ventilimi i kontrolluar me CO2 kursen energji, veçanërisht gjatë orëve të natës. Studimet tregojnë se nevoja e shpendëve për ajër të pastër është deri në 50% më e ulët gjatë fazës së prehjes në krahasim me fazën aktive.

Rezistenca minimale e ajrit

Energjia e nevojshme për të nxitur një shpejtësi të caktuar të ventilimit varet nga rezistenca e ajrit e të gjithë sistemit të ventilimit. Meqenëse rezistenca e ajrit rritet proporcionalisht me shpejtësinë e ajrit, seksioni kryq i tubave

të ajrit duhet të përshtatet në përmasa, në mënyrë që shpejtësia e ajrit të jetë sa më e ulët, më pak se tre metra në sekondë. Ndryshimet në drejtim dhe tërthore/në diametër duhen shmangur. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet dizajnit të oxhakut të shkarkimit. Meqenëse në oxhak mbizotëron shpejtësia e ajrit deri në dhjetë metra për sekondë, për shembull në rastin kur oxhaku është i mbuluar, ka një efekt të madh në konsumin e energjisë. Duke izoluar pjesërisht hyrjen e oxhakut, konsumi specifik i energjisë së ventilatorit mund të reduktohet me rreth 10%.

Kontrolli i ventilatorit për të kursyer energji

Ka disa mënyra për të kontrolluar vazhdimisht shpejtësinë e ventilatorit. Ato ndryshojnë në efikasitetin e tyre në energji dhe në çmim.

Konvertuesi i frekuencës

Një metodë e dytë e kontrollit bazohet në ndryshimin e frekuencës. Konvertuesit e frekuencës përfshijnë një rregullator që konverton tensionin AC (50 Hz) në DC dhe një inverter që ndryshon DC-në përsëri në AC, një ose trefazor me frekuencë të ndryshme. Përveç një niveli të favorshëm efikasiteti, kontrolli i frekuencës lejon që shpejtësia e ventilatorit të reduktohet nën 15%. Për shkak të nxehtësisë që krijohet, kjo nuk rekomandohet për kontrollin e këndit fazor. Konvertuesi i frekuencës është më i shtrenjtë sesa inverteri fazor. Megjithatë, në shumicën e sistemeve ekzistuese të ventilimit, rikonstruksioni është i mundur pa zëvendësuar kabllot dhe ventilatorët.

Ventilatorë ETAvent

Metoda e tretë e kontrollit të ventilimit është përdorimi i ventilatorëve ETAvent. Kjo metodë kërkon një motor DC (motor EC) pa fibra karboni me magnet të përhershëm dhe një qark të integruar. E thënë thjesht, kontrolli i shpejtësisë është tashmë i integruar në motorin e ventilatorit. Këta lloj ventilatorësh janë më eficientë se ventilatorët (motorët asinkron) me kontroll të frekuencës.



Ventilatorët që konsumojnë më pak energji, për shkak të çmimit të tyre, nuk janë shumë të përdorshëm në pulari. Shpenzimet shtesë për këta ventilatorë me komandim, me diametër 63 cm, për stallat e pulave, arrijnë në rreth 300 euro për ventilator. Sa energji mund të kursehet për ventilator varet nga shpejtësia mesatare e tij. Si rregull, shpejtësia mesatare gjatë vitit nuk është as 40%. Ekstrapolimet e bazuara në matjet e performancës tregojnë se rreth 1300 kwh mund të kursehen në vit për ventilator me diametër 63 cm. Me çmimet aktuale të energjisë elektrike, duhen dy deri në pesë vjet, në varësi të diametrit të ventilatorit, derisa kostot shtesë për blerjen e tyre të mbulojnë përmes kursimit në konsumin e energjisë. Përveç konsumit më të ulët të energjisë, ventilatorët e kontrolluar me frekuencë dhe ETAvent kanë avantazhe të tjera. Për shkak të gjenerimit më të ulët të nxehtësisë, ato mund të rregullohen në një nivel më të ulët, në një shpejtësi prej më pak se 10% dhe janë më të qeta.

Për më shumë informacion:



**Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve**

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

6. NDIKIMI I TEMPERATURAVE TË LARTA TE SHPENDËT

Përpunuar nga Jon Zeneli

Temperatura, lagështia dhe drita janë ndër faktorët më të rëndësishëm për një klimë të mirë dhe të qëndrueshme. Eksperti GOTTFRIED ETLINGER spjegon masat që duhen marrë për të maksimizuar performancën e shpendëve sipas gjenetikës së tyre.

Nevojat e temperaturës varen kryesisht nga mosha dhe lloji i shpendëve. Kërkesat për temperaturën e ambientit përcaktojnë kryesisht aftësinë e kafshëve për të rregulluar ujin në trup. Patat, rosat dhe gjeli i detit kanë një nevojë relativisht të lartë për temperaturë në ditët e para krahasuar me shpendët e tjera më të mëdha në moshë. Te pulat, kërkesa e temperaturës bie më shpejt.

Temperatura ideale

Temperatura ideale gjithashtu varet nga sistemi i ngrohjes. Në rastin e ngrohjes së gjithë hapësirës, temperatura prej 33 deri 34 ° C duhet të jetë disi më e lartë sesa në rastin e ngrohjes me rrezatim, 31 deri 32 ° C. Në rastin e ngrohjes me rrezatim, temperatura afër ngrohësit është më e lartë dhe zogjtë mund të zgjedhin të distancohen nga radiatorit. Është e rëndësishme që temperatura të matet në lartësinë e zogjve në disa pika të ndryshme në stallë.

Vëzhgoni me kujdes që në fillim

Në ditët dhe javët e para duhet të shikoni nga afër shpendët. Sjellja e zogjve tregon nëse temperatura në pulari ose në fermë është optimale. Nëse temperatura është shumë e ulët, shpendët grumbullohen së bashku dhe mund të shtypin njëra-tjetrën. Nëse është shumë e lartë, shpendët shtrihen me krahët e hapura.

Shpërndarja e barabartë e zogjve tregon se temperatura është optimale. Nëse temperatura e tokës është shumë e ulët, nën 30 ° C, zogjve ju ftohen këmbët. Kjo është arsyeja pse ju duhet të kontrolloni herë pas here këmbët e zogjve nga secila zonë e ambientit të brendshëm. Këmbët e tyre duhet të ndjehen të ngrohta.

Këshilla për një temperaturë të balancuar

- Kontrolloni vazhdimisht opsionet e ventilimit dhe alarmit
- Rritni shpejtësinë e ajrit në zonën ku rrinë shpendët
- Ftohni ajrin, p.sh. „Cool-Pads“
- Ujitni taracën (sidomos kur ka izolim të dobët)
- Errësoni dritaret kur bie direkt dielli

• Kontrolloni lagështinë dhe sigurohuni që kashta të jetë e thatë

• Ushqyerja gjatë periudhës më të freskët të ditës (në mëngjes dhe në mbrëmje)

• Kushtojini vëmendje kohës së shkurtër të qëndrimit dhe të pritjes kur ngarkoni shpendët në mjetet e transportit

Ditët e nxehta shkaktojnë probleme

Ditët e nxehta të verës mund të shkaktojnë probleme në blegtori. Nga njëra anë, shpendët hanë më pak ushqim në temperatura të larta, si dhe vihet re ulje e performancës dhe cilësisë së produktit, të tilla si peshja e vezës dhe cilësia e lëvozhgës. Nga ana tjetër, nxehtësia nënkupton një stres të madh në qarkullim për shpendët. Shpendët e majmërisë në veçanti vuajnë në pjesën e fundit të majmërisë dhe ngarkohen kur temperatura e ambientit është shumë e lartë. Mund të ndodhin raste të ngordhjes së shpendëve. Kur temperaturat ditore maksimale shkojnë në 30 ° C duhen marrë masa për të shmangur dëmet nga nxehtësia. Sidoqoftë, duhet bërë një përgatitje paraprake.

Lagështia e ajrit duhet të jetë optimale

Lagështia optimale relative për shpendët është midis 50 dhe 70%. Kur shpendët janë në moshë të madhe, një nivel pak më i lartë i lagështisë është më i dëshirueshëm sepse shpendët nuk thahen dhe ajri i lagësht ruan më shumë nxehtësi. Në fazën e ndryshimit të pendëve, një lagështirë më e lartë e ajrit është më e favorshme sesa ajri shumë i thatë. Kjo e mban lëkurën më të lëmuar dhe e bën më të lehtë shpimin nga dalja e pendëve.

Me rritjen e moshës, lagështia rritet për shkak të frymëmarrjes së shpendëve dhe jashtëqitjeve, kështu që balancimi i duhur duhet të bëhet përmes ventilimit dhe ngrohjes. Vlera maksimale nuk duhet të kalojë rreth 70% dhe mbetjet e plehut duhet të mbahen kryesisht të thata. Në të njëjtën kohë, lagështia shumë e ulët gjithashtu ka një efekt negativ në performancën dhe shëndetin e shpendëve. Nëse ambienti është me lagështi të lartë ose i thatë dhe me pluhur, rreziku i infeksionit rritet, për shembull E.Coli për shkak të rritjes së formimit të pluhurit, si dhe rreziku i kanibalizmit dhe pickimit të pendëve.

Kushtet e dritës

Kushtet e ndriçimit në stalla kanë një efekt shumë kompleks në karakteristikat e ndryshme të performancës së shpendëve. Drita jo vetëm që ndikon në marrjen e ushqimit dhe zhvillimin e shpendëve, por gjithashtu ndikon në pjekurinë seksuale dhe performancën e tyre. Kohëzgjatja e ndriçimit, intensiteti i dritës dhe ngjyra e dritës janë të rëndësishme. Kërkesat e shpendëve ndryshojnë sipas moshës dhe specieve.

Intensitet i lartë i dritës

Në ditët e para të jetës intensiteti i dritës duhet të jetë më i lartë dhe më pas të ulet gradualisht. Sidomos me zogjtë e gjelit të detit, 80 deri në 100 luks rekomandohen në javën e parë të jetës. Deri në fund të javës së dytë të jetës, intensiteti i dritës zvogëlohet në 20 luks. Në rritjen e broilerit, në fazën fillestare rekomandohet 60 luks në mënyrë që shpendët të gjejnë ushqimin dhe ujin.

Drita gjatë ditës

Drita gjatë ditës luan një rol të madh në llojet e ndryshme të pulave. Në fazën e majmërisë së pulave, programi i dritës duhet t'i përshtatet rritjes së kafshëve. Periudhat e errëta duhet të bazohen në ritmin natyror ditë-natë dhe të mbulojnë një të tretën e ditës, por pulat duhet të kenë të paktën dy faza të errëta të pandërprera prej katër orësh secila.

Gjatë majmërisë së gjelit të detit në ambientet e hapura, kohëzgjatja dhe intensiteti i dritës i nënshtrohen kushteve klimatike dhe sezonale. Duke marrë masat e duhura, rrezet e diellit direkte duhet të shmangen, pasi kjo mund të inkurajojë daljen e pendëve.

Siguroni dritë natyrale

Në rastin e strukturave të reja dhe të rinovuara, duhet të sigurohet dritë natyrale, ku zona e rënies së dritës duhet të jetë së paku 3% e hapësirës. Ndriçimi artificial mund të përdoret gjithashtu në strukturat e mbyllura, të vjetra dhe në stalla me ku ka ndriçim natyral. Edhe në majmërinë e gjelit të detit, periudha e errët duhet të mbulojë 1/3 e ditës, minimalisht duhet të garantohen të paktën dy faza të errëta prej katër orësh. Në rritjen e pulave, ditët e dritës me 14 deri në 16 orë janë provuar të suksesshme. Frekuenca e dritës varet nga burimi i dritës. Tubat fluoeshente dhe llambat ekonomike që punojnë në intervalin e ulët të frekuencës prej 50 deri në 100 Hz janë të pafavorshme për zogjtë e pulës.

Pulat ndjejnë pulsimin e dritës, që mund të ketë një efekt negativ në sjelljen e tyre. Prandaj, preferohen llambat LED ose tubat fluoeshente që punojnë me frekuenca të larta prej më shumë se 2,000 Hz.

Përmbledhje

Klima në pulari dhe në fermë është një faktor i rëndësishëm mjedisor që fermerët duhet t'a marrin në konsideratë në mënyrë që të parandalojë humbjet e shpendëve dhe të mos rrezikojë cilësinë e produkteve të pulave. Faktorët kryesorë që duhen marrë parasysh janë kërkesat për temperaturë të lartë në fazën fillestare, rregullimi i lagështisë në fazat individuale të jetës dhe kontrolli i kushteve të ndriçimit, të cilat kanë një efekt shumë kompleks në karakteristikat e ndryshme të performancës së shpendëve.

Për më shumë informacion:



Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

7. PRODHIMI I VEZËVE: PËRZIERJET OVITAL

Përpunuar nga Jon Zeneli

Në universitetet e Göttingen dhe Rostock në një eksperiment 4-6 mujor, u studiuua performanca e pulave për vezë, të cilat përdorën përzierjet me Tri-Ovital dhe Ovital-intensiv.

Në eksperimentin në Göttingen, 96 pula u mbajtën në kafaze individuale, kurse në Rostock 200 pula u mbajtën në sistem dysheme dhe 96 pula në kafaze (2 pula/kafaz). Në Göttingen, u përdor lloji Lohmann kaf, nga java e 21/22. deri në javën e 37/38 të jetës. Në Rostock u përdor Tetra kafe për një periudhë prej 6 muajsh (javën e 24-të deri në 50-të të jetës). Përbërësit e përdorur janë paraqitur në figurën 1. Figura 2 tregon se në të dy sistemet e mbarështimit u arritën rezultate shumë të mira me përzierjet Ovital. Përveç gjenetikës së ndryshme të pulave, sigurisht që ka dallime, edhe për shkak të sistemit të mbarështimit.

Vlen të përmendet performanca e lartë e prodhimit prej 95,5%, e cila u arrit me një konsum jashtëzakonisht të ulët të ushqimit prej 114 g/ditë (në eksperimentin Göttingen). Përveç gjenetikës së duhur, rezultate të tilla mund të arrihen vetëm me ushqim të sofistikuar, me një përzierje të miellit të grurit, sojës dhe Tri-Ovital.

Gjithashtu edhe receta me përbërës Ovital-intensiv në Rostock, rezultoi e suksesshme sepse performanca ishte në nivele të kënaqshme. Pula Tetra kafe ka një peshë më të madhe dhe konsumon më tepër ushqim. Kjo ndikon dhe te pesha e vezëve, rrjedhimisht më e madhe.

Në të dyja eksperimentet, pavarësisht gjenetikës së pulave dhe llojit të sistemit të mbarështimit, u arrit një performancë e shkëlqyer

Fig. 1: Përzierja e ushqimit

		Universiteti Göttingen (Java e jetës 21-37)	Universiteti Rostock (Java e jetës 24-48)
Gruri	%	66,5	42,0
Miell soje 44	%	22,0	26,0
Misër	%	-	20,0
Kalk	%	7,50	8,0
Vaj soje	%	2,0	2,0
TRI-OVITAL	%	2,0	-
OVITAL-INTENSIV	%	-	2,0
Përbërësit			
Proteinë e papërpunuar	g/kg	179	192
ME	MJ/kg	11,4	11,2
Lizinë	g/kg	8,9	9,3
Metioninë	g/kg	4,0	4,0
Kalcium	g/kg	33,3	34,0

Fig 2: Parametrat e prodhimit

	Ushqimi g/Ditë	Pesha mesatare e vezës g	Pesha e vezës g/ditë	Ushqim i shpenzuar në g për peshën e vezës g	Performanca e prodhimit %
Universiteti Göttingen Lohmann Brown	114	58,8	56	2,03	95,5
Universiteti Rostock Tetra kafe					
Kafaz Dysheme	129,5 131,0	62,2 62,7	56,3 51,1	2,29 2,57	90,5 81,5

Për më shumë informacion:

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

8. PULAT PËR VEZË: TË USHQYERIT SIPAS KËRKESAVE TË SHPENDIT

Përpunuar nga Kristian Maka

Një faktor i rëndësishëm i dëmtimit të pendëve të pulave për vezë është kequshqyerja. Për këtë duhet të sigurohet konsum i lartë i ushqimit dhe përmbajtje konstante e lëndëve ushqyese duke u bazuar te nevojat për ushqim.

E thënë thjesht: ushqimi duhet të jetë i shijshëm. Për të shmangur ngrënien selektive, ushqimi duhet të ketë pak tendencë për t'u ndarë. Veçanërisht në periudhën deri në javën e 25-të të jetës është e mjaftueshme për të mbuluar kërkesën për lëndë ushqyese. Masat e synuara për të rritur konsumin përfshijnë:

- Përdorimi i ushqimit paraprak për të mundësuar që pulat të mësohen gradualisht me ushqimin (shmangni ndryshimet e papritura të ushqimit)
- Konsumimi i shpejtë i ushqimit
- Pas konsultimit me veterinerin, përdorimi i qumështit të skremuar pluhur, rignonit, magnezit etj

Madhësia e grimcave	Zona e synuar	
	Min.	Max.
> 2,5 mm	-	5%
2,0-2,5 mm	10%	15%
1,6-2,0 mm	15%	25%
1,0-1,6 mm	25%	40%
0,5 – 1,0 mm	15%	25%
< 0,5 mm	25%	20%

Vlerat e synuara:

- Fibra të papërpunuara:
 - ♦ të paktën 4% në vitin e parë të jetës
 - ♦ të paktën 4% deri në javën e 70-të të jetës
 - ♦ më pas të paktën 5%
- Metioninë:
 - ♦ 0,40 deri në 0,42%
- Natrium:
 - ♦ 0,17 deri në 0,18%
- Magnez:
 - ♦ 0,2 deri në 0,3%

Niveleve të natriumit dhe metioninës duhet t'i kushtohet vëmendje. Një përmbajtje e papërpunuar e fibrave prej të paktën 4% (5% në fazat e mëvonshme të prodhimit) është e rëndësishme dhe shpesh nuk arrihet në përzjerjet e fermave me një përqindje të lartë misri dhe HP (high protein - proteina të larta) miell soje. Përzjerjet speciale të ushqimit për të reduktuar humbjen e puplave kanë një përmbajtje të shtuar të fibrave të papërpunuara, metioninës, natriumit dhe magnezit me densitet të reduktuar të energjisë dhe gjatë studimeve kanë sjellë efektet e dëshiruara në këtë drejtim.

Struktura homogjene e ushqimit - shmangni marrjen selektive të ushqimit

Nëse ushqimi ka një përbërje heterogjene të madhësisë të grimcave të ushqimit, ndodh marrja selektive e ushqimit. Pulat që arrijnë të parat tek ushqimi (p.sh. zinxhiri i ushqimit, ndarja e parë) preferojnë të hanë përbërësit e trashë dhe me energji të lartë. Këto pula mbifurnizohen me energji dhe kanë mangësi në aminoacide dhe minerale, sepse këto lëndë ushqyese gjenden në grimcat më të imta të ushqimit. Kjo mund të sjellë si pasojë humbjen e pendëve. Një kontroll i strukturës së ushqimit me madhësi të ndryshme site tregon shpesh se ka shumë grimca të trasha (> 2,5 mm) dhe shumë pak grimca të imta në fraksionin e madhësisë së dëshiruar (1 deri në 2 mm). Grimcat e trasha të ushqimit nuk përmbajnë pothuajse fare natrium, pak metioninë dhe kalcium, por shumë energji.

Rekomandime për shpërndarjen e madhësisë së grimcave të ushqimit të pulave

Shmangni marrjen selektive të ushqimit:

- ♦ Përdorni ushqim me një strukturë të barabartë, jo rrëshqitëse, pa përmasa të shtuara të grimcave të trasha ose të imëta në përputhje me rekomandimet.
- ♦ Ofroni gëlqere ose zhavorr ushqimor të disponueshëm lirisht
- ♦ Kontroll i rregullt i strukturës së ushqimit me anë të analizës së sitës
- ♦ Shpejtësia e lartë e zinxhirit (nëse është e mundur >15 m/min), gjë që e bën të vështirë zgjedhjen e përbërësve individualë të ushqimit

- Lejoni që zinxhiri i ushqimit të kryejë më shumë se një rrotullim
- Gjatë kalimit zbrazni siloset e ushqimit, rregullisht dhe plotësisht
- Shpendëve duhet t'u ofrohen gurë stomaku /zhavorr të patretshëm (madhësia e kokrrave 3 deri në 4 mm, 1 deri në 2 g/shpend), veçanërisht nëse ka një përqindje të lartë të grimcave të trasha në ushqim. Gurët në stomak ndihmojnë muskujt e stomakut për të bluar ushqimin.

Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

9. RËNDËSIA E UNIFORMITETIT TE PULAT

Përpunuar nga Jon Zeneli

Devijimi nga kriteret e cilësisë rrit rrezikun e dëmtimit të pendëve dhe lëkurës së zogave. Pulat për vezë që shfaqin humbje të pendëve gjatë rritjes, shpesh e hasin këtë sjellje edhe gjatë periudhës së prodhimit.

Pesha e shpendëve nën objektivin e mbarështuesit dhe uniformiteti i dobët i tufës janë faktorë rreziku të rëndësishëm për dëmtimet e pendëve. Sa më uniforme të jetë tufa e pulave, aq më e madhe është mundësia e një zhvendosjeje pa probleme.

- Kontaktoni mbarështuesin tuaj shumë përpara se të merrni zogat. Një vizitë në stallë mund të jetë gjithashtu e dobishme.
- Bini dakord për kriteret për të cilat dëshironi të informoheni për zogat (p.sh. zhvillimi i peshës, aktiviteti, ndriçimi dhe të ushqyerit).
- Merrni pjesë në një kurs trajnimi për të vlerësuar shpendët, p.sh. dëmtimet e pendëve, zhvillimi fizik.

Kriteret e cilësisë:

- Pesha: pas mbërritjes pesha duhet të jetë së paku sa pesha e synuar e mbarështuesit
- Pendët, pesha dhe niveli i zhvillimit sa më uniform që të jetë e mundur (uniformiteti të paktën 80% për pulat kafe, të paktën 85% për pulat e bardha)
- Gjendja e kafshës: nuk ka dëmtime të pendëve, lëkurës dhe gishtërinjve
- Mosha e zhvendosjes: në javën e 17 - 18 të jetës

Pasi zogat të kenë mbërritur, trupi dhe gjendja e pendëve duhet të kontrollohen me kujdes për të identifikuar dhe vlerësuar dëmtimet e mundshme të tyre.

Përshtatje pa probleme me ambientin e ri

Kur pulat e reja zhvendosen në pulari, ato përballen me kushte të reja, të panjohura. Në të njëjtën kohë, ato kanë zhvillim të konsiderueshëm të trupit dhe fillojnë prodhimin e vezëve brenda pak javësh.

Faza e kalimit në pulari dhe aklimatizimi i mëvonshëm është jashtëzakonisht i ndjeshëm për tufën për shkak të ndryshimeve hormonale, kushteve të reja ambientale, performancës së lartë për rritjen dhe fillimin e prodhimit të vezëve.

Për një aklimatizim të qetë, në mënyrë analoge me mbarështimin duhet të merren parasysh sa më shumë faktorë që të jetë e mundur. Për këtë, nga mbarështuesi kërkohet informacioni i mëposhtëm:

- Fillimi dhe mbarimi i ditës (dritës)
- Kohëzgjatja e fazës së muzgut: p.sh. 30 deri në 50 minuta
- Ritmi ditë/natë: të paktën 8 orë errësirë dhe të paktën 8 orë dritë
- Sistemi i mbarështimit dhe mënyra e të ushqyerjes
- Koha e ushqyerjes dhe ushqimi i përdorur në kohën e zhvendosjes

Faktorë që ndikojnë në aktivitetin e pulave

Nëse shfaqen devijime nga kriteret e cilësisë, mund të jetë e dobishme të shtyhet fillimi i zgjatjes së dritës së ditës, me shtatë deri në 14 ditë. Ushqimi suplementar (p.sh. magnez, aminoacide, vitamina B, aditivë bimorë si rigoni) duhet të përdoret vetëm pas konsultimit me veterinerin.



Masat e rëndësishme për aklimatizim përfshijnë:

- Peshimi javor dhe vlerësimi i gjendjes së puplave për 50 pula deri në javën e 30-të të jetës, pastaj peshimi mujor (matje e rastësishme nga të gjitha nivelet dhe ndarjet).
- Në zonën e shtratit, fillimisht përdorimi i kashtës dhe më pas peletave për ta mbajtur atë të thatë. Shpërndarja dy herë në ditë nxit angazhimin me materialin.
- Kontrolle të shpendëve dhe vëzhgim nga afër disa herë në ditë.
- Marrja parasysh e faktorëve që ndikojnë në aktivitetin e shpendëve.

10. IMPAKTI I SALMONELËS TE SHPENDËT

Përpunuar nga Jon Zeneli

Salmonela është një problem serioz jo vetëm në mbarështimin e shpendëve, por edhe për shëndetin e njerëzve. Shfaqja e më shumë se 2600 serotipeve të ndryshme të salmonelës në pulat e majmërisë dhe gjelat e detit është e dënueshme nga autoritetet.

Salmonelat janë baktere të zorrëve që mund të shkaktojnë infeksione gastrointestinale te njerëzit dhe kafshët.

Salmonela përbëhet nga dy lloje kryesore: Salmonela bongori, e cila gjendet kryesisht te zvarranikët dhe Salmonela enterica, e cila gjendet kryesisht te kafshët me gjak të ngrohtë dhe mund të infektojë njerëzit. Salmonela enterica përmban 6 nënspecie që klasifikohen më tej në serovarë sipas specifikës antigjenike. (> 2600).

Serotipet specifike përshtaten me mbartësin përkatës dhe mund të shkaktojnë sëmundje të rënda (p.sh. Salmonella Gallinarum). Serotipet jospecifike të Salmonelës mund të infektojnë një numër të madh mbartësish dhe shkaktojnë sëmundje vetëm pjesërisht.

Serovarët më të zakonshëm në infeksionet e njerëzve dhe shpendëve janë serovarët jospecifikë të mbartësit Salmonela Enteritidis (SE), Salmonela Typhimurium (ST) dhe Salmonela Infantis (SI).

SI është serovari më i zakonshëm i zbuluar te shpendët, te brojlerët dhe serovari i tretë më i zakonshëm në infeksionet e njerëzve. SI është i vështirë për t'u hequr nga stalla, edhe pse merren masat e pastrimit dhe dezinfektimit të plotë.

Salmonela mund të prekë tufat në mënyra të ndryshme. Dallohen disa lloje transmetimesh të saj: transmetimi horizontal, nëpërmjet kontaktit me objekte ose kafshë të infektuara dhe transmetimi vertikal, në të cilin Salmonela transmetohet nga prindërit e infektuar te zogjtë nëpërmjet vezës. Transmetimi horizontal është burimi më i zakonshëm i infeksionit për shpendët, nëpërmjet feçeve, ushqimit, ujit, makinerive, veshjeve, si dhe nëpërmjet brejtësve, insekteve, zogjve të egër, kafshëve shtëpiake dhe vizitorëve të ndryshëm në stallë.

Parandalimi i infeksionit nga Salmonela bazohet kryesisht në dy shtylla: biosiguria dhe vaksinimi.




Fig.2 Llojet e ndryshme të kafshëve nuk duhet të kenë kontakt me njëra-tjetrën.

Fig.1 Salmonela mund të grumbullohet në një paradhomë të ndotur dhe të parregullt.



Baza për biosiguri të mirë është struktura e stallës, p.sh, ekzistenca e një paradhome me një zonë bardhë e zi, që pastrohet dhe dezinfektohet rregullisht. Gjithashtu, duhet të merren masa për të parandaluar hyrjen e kafshëve të egra. Për të ruajtur një nivel të lartë të biosigurisë është thelbësore krijimi dhe mbajtja e një plani higjienik.

Vaksinimi mbron shpendët nga infeksioni në rast se Salmonela hyn në pulari. Një kombinim i vaksinave të gjalla dhe vaksinave të inaktivizuara ka rezultuar i suksesshëm. Vaksinat e gjalla synojnë të parandalojnë kolonizimin e zorrëve me Feld-Salmonelën.

Nëse salmonelat kanë arritur të vendosen në zorrë, vaksinat e inaktivizuara formojnë antitrupa dhe në këtë mënyrë pengojnë shumëzimin e Feld-Salmonelës.

Në përmbledhje, një program i mirë vaksinimi dhe një menaxhim i mirë i higjienës janë thelbësore për të parandaluar hyrjen e Salmonelës në pulari. Kontrolltet e rregullta në ambientet e brendshme nga veterineri mbikëqyrës janë të rëndësishme për të shmangur “verbërinë” e mundshme operationale.

Për më shumë informacion:

11. SHMANGIA E DERMATITIT TE KËMBËT E PULAVE

Përpunuar nga Jon Zeneli

Gjendja shëndetsore e shputës së këmbëve të pulave është një kriter thelbësor i mirëqenies së tyre. Infiamacioni kufizon lëvizshmërinë e pulave, ka një efekt negativ në gjendjen e përgjithshme shëndetsore dhe sjelljen ndaj të ushqyerit.

Dermatiti i këmbëve të pulave (Footpad Dermatitis, FPD) është një problem i zakonshëm, i cili po merr vëmendje të shtuar në mbarëstimin e tyre. Sipas kompanisë AVIAGEN një nga faktorët që ndikon në mirëqenien e pulave është padyshim edhe shëndeti i këmbëve.

Shtroja e lagësht është shkaktari kryesor i infiamacionit të këmbëve. Shtroja e thatë dhe një klimë e mirë e qëndrueshme janë thelbësore për shëndetin dhe mirëqenien e pulave.

Vlerësimi i gjendjes shëndetsore së këmbëve

Në tufat e shpendëve janë zhvilluar sisteme të ndryshme matëse, për të vlerësuar shfaqjen dhe gradën e infeksioneve të këmbëve. Sistemi EFSA me 3 pjesë është i pranuar në Europë dhe bën dallimin midis këmbëve të shëndetshme, këmbëve me ndryshime të lehta dhe këmbëve me ndryshime të rënda. Ky vlerësimi bëhet në thertore dhe jo vetëm.

Shkaqet e shfaqjes së infiamacionit

Shfaqja e infiamacionit të këmbëve është e lidhur me cilësinë e shtrojës. Shtroja e lagësht, ngjitëse dhe me kore rrit rrezikun e infiamacionit. Mënyra më e mirë për të parandaluar infiamacionin është mbajtja e shtrojës së thatë dhe të grimtuar.

Cilësia e shtrojës ndikohet nga një sërë faktorësh:

- ♦ Menaxhimi i shtrojës (materiali dhe thellësia e shtrojës)
- ♦ Drita: shpërndarja e dritës, ngjyra e dritës dhe programet e dritës
- ♦ Furnizimi me ujë dhe menaxhimi i ujit
- ♦ Ventilimi dhe ngrohja
- ♦ Ushqimi
- ♦ Dendësia e stokut

Këshillat e mëposhtme mund të ndihmojnë mbarështuesit e shpendëve që të ruajnë cilësinë e mirë të shtrojës dhe të parandalojnë infiamacionin.

Përgatitja e stallës së shpendëve

- ♦ Pastroni, dezinfektoni dhe thani siç duhet stallën
- ♦ Kontrolloni të gjitha pajisjet e stallës dhe nëse është e nevojshme kryeni riparime (p.sh. sistemi i ventilimit, hyrjet e ajrit, sistemi i ngrohjes).
- ♦ Para se të vendosni shtrojën, ngrohni dyshemenë deri në 30 C.
- ♦ Kontrolloni sistemin e ujit të pijshëm për rrjedhje, kryeni riparimet e nevojshme ose zëvendësoni pjesët që mungojnë.
- ♦ Pastroni linjat e ujit përpara instalimit.

Materiali i shtrojës dhe menaxhimi i saj

- ♦ Përdorimi i shtrojës me torfe çon në krijimin e më pak lezimeve të këmbëve, sesa kur përdoret shtrojë me ashkla druri ose kashtë.
- ♦ Nëse përdoret kashtë gruri, është më mirë që kashta të pritet (gjatësia e prerjes nga 2 deri në 4 cm). Kjo rrit kapacitetin e thithjes së ujit.

Në lidhje me shpeshtësinë dhe ashpërsinë e infeksioneve të këmbëve, një përzierje torfe/ashkla druri ose torfe/kashtë e copëtuar si material për shtrojën është më mirë se sa përdorimi vetëm i ashklave të drurit ose kashtës së copëtuar. Rezultatet eksperimentale kanë treguar se përdorimi i lignocelulozës çon në infiamacion më të lehtë sesa kur përdoren copat e drurit dhe kashta, por kjo mbetet akoma për t'u vërtetuar.

- ♦ Një shtresë e hollë e shtrojës (0,5 deri në 7,0 kg/m²) mund të jetë e dobishme për të kontrolluar infeksionet e këmbëve, me kusht që temperaturat e tokës të jenë të sakta.
- ♦ Nëse aplikohet një shtresë e hollë e shtrojës, dyshemeja duhet të ngrohet paraprakisht në të paktën 30°C.
- ♦ Mos e përhapni materialin e shtrojës derisa dyshemeja të ketë arritur temperaturën e synuar prej 30°C.
- ♦ Hiqni shtrojën e lagur dhe zëvendësojeni me shtrojë të pastër, të thatë dhe të freskët.

Furnizimi dhe menaxhimi i ujit

- Mirëmbani dhe kontrolloni rregullisht sistemet e hidratimit.
- Zëvendësoni të gjithë sistemin e hidratimit çdo 5-7 vjet.
- Përdorni vetëm ujë të cilësisë së mirë.
- Lani dhe dezinfektoni rregullisht linjat e ujit për të reduktuar rrjedhjet duke parandaluar ndotjen dhe akumulimin e biofilmave.
- Lani linjat e ujit përpara se të strehohen zogjtë, deri në dy javët e para të jetës periodikisht
- Shmangni presionin e tepërt të ujit, veçanërisht gjatë dy javëve të para pas instalimit.
- Sigurohuni që linja e ujit të jetë e niveluar për të siguruar furnizim të barabartë të ujit përgjatë gjithë gjatësisë së linjës.
- Rregulloni çdo ditë linjën e pirjes në lartësinë e shpendëve. Nëse linja e pirjes së ujit është e vendosur shumë poshtë, shtroja do të ishte e lagur. Acidifikimi i ujit mund të ndihmojë në uljen e ashpërsisë së infeksioneve të këmbëve. Kontrolloni furnizimin me ujë në mënyrë të vazhdueshme.

Shpërndarja e dritës, ngjyra e dritës dhe programi i dritës

- Përdorimi i një programi me ndërprerje të dritës mund të jetë i dobishëm në zvogëlimin e e shfaqjes së dermatitit të këmbëve.
- Shfaqja e infeksioneve është më e ulët në rastin kur përdoren llambat inkandeshente, por kostot e energjisë janë më të larta në krahasim me dritat fluoreshente.
- Drita duhet të shpërndahet në mënyrë të barabartë në të gjithë stallën. Tubat fluoreshente që varen vertikalisht në përgjithësi kanë një shpërndarje më të mirë të dritës në krahasim me tubat fluoreshente që varen nga tavani.
- Intensiteti i dritës më pak se 20 lux nuk ka asnjë përfitim në reduktimin e infeksioneve të këmbëve.
- Ka vetëm një ndikim të kufizuar të ngjyrës së çelur në shfaqjen e inflamacionit. Drita jeshile/drita blu duket se rezultojnë në më pak inflamacion. Megjithatë, nuk është e qartë nëse intensiteti i dritës i përcaktuar në direktivën evropiane të rritjes së broilerave mund të arrihet me këtë sistem ndriçimi.

Ventilimi dhe ngrohja

- Përdorimi i ngrohjes qendrore është më i preferuar sepse prodhohet më pak lagështi.
- Shpërndarja e nxehtësisë duhet të jetë uniforme në të gjithë stallën dhe sistemi i ngrohjes duhet të përshtatet siç duhet me madhësinë e saj.

- Ndrohja nën dysheme siguron kontroll më të mirë të temperaturës së dyshemesë, gjë që ndihmon në reduktimin e shfaqjes së dermatitit të këmbëve.
- Përdorimi i një profili të temperaturës me një ulje graduale mund të ndihmojë në uljen e rrezikut nga dermatiti.
- Qarkullimi i ajrit para dhe pas hyrjes në stallë është i dobishëm.
- Është e rëndësishme të monitorohet/kontrollohet lagështia relative në stallë. Lagështia relative duhet të jetë ndërmjet 50% dhe 70%. Nëse lagështia relative është mbi 70%, nevojitet ventilim shtesë dhe ndonjëherë ngrohje.
- Nëse stalla është e pajisur me një sistem ftohjeje me sprucim, ky duhet të jetë në gjendje të mirë pune. Përmasat më të mëdha të pikave ose bllokimet në grykat e spërkatjes rrisin rrezikun që shtroja të jetë lagur dhe, si rrjedhje, rritet edhe mundësia e infeksioneve të këmbëve.

Ushqimi

- Rreziku i infeksioneve të këmbëve zvogëlohet, nëse prodhuesit e ushqimit të kafshëve përdorin lëndë të para shumë të tretshme, i bazojnë racionet e tyre të ushqimit në aminoacide të tretshme dhe shmangin nivelet e larta të natriumit dhe kaliumit në ushqim,
- Sigurohuni që nivelet e zinkut, biotinës dhe vitaminës B në ushqim të jenë të përshtatshme.
- Shtimi i mineraleve të argjilës në dietë mund të ndikojë pozitivisht në cilësinë e shtrojës dhe rrjedhimisht në shfaqjen e plagëve në këmbë.
- Balancimi ditor i përbërjes së ushqimit duke shtuar drithëra të plota mund të jetë një mënyrë efektive për të reduktuar inflamacionin.
- Nëse shfaqen probleme me zorrët dhe probleme me shtrojën e lagësht, mbarështuesi i shpendëve mund të hollojë/zgjatë racionet e ushqimit me ushqim shtesë me drithëra të plota.

Dendësia e stokut

- Dendësia e stokut duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi, megjithatë, një dendësi më e ulët e stokut është e dobishme për reduktimin e inflamacionit.
- Nëse kushtet e strehimit dhe menaxhimi nuk përputhen, rritja e densitetit të stokut do të çojë në një rritje të infeksioneve të këmbëve.

Për më shumë informacion:

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al



12. MËNYRA EFEKTIVE PËR SHMANGIEN E STRESIT TE PULAT

Përpunuar nga Kristian Maka

Gjatë mbarështimit të pulave për vezë, gjetja e një aktiviteti për to është e rëndësishme, sepse në këtë mënyrë shmangen çrregullimet e sjelljes, të tilla si "çukitja e pendëve" apo "kanibalizmi". Njohja e shkaqeve, të cilët janë të shumtë dhe strategjive të shmangies së këtyre çrregullimeve të sjelljes është thelbësore.

Proteinat me cilësi të lartë, struktura e mirë e fibrave të papërpunuara dhe një përmbajtje e lartë e grurit janë të një rëndësie vendimtare në mbarështimin e pulave, përse i përket aspektit fiziologjik të tretjes.

Në fermat e mëdha, angazhimi i mjaftueshëm i pulave është një sfidë e madhe.

Një mbarështues pulash për vezë nga Emsland, Gjermani, zotëron gjithashtu një fabrikë biogazi. Teknologjia e silazhit të misrit dhe ngarkimit të substratit duke përdorur ngarkues me rrota nuk është asgjë e re për të.

Fermeri ka hartuar një plan, me qëllimin që pulat e tij të jenë në aktivitet të vazhdueshëm. Ai planifikon të mbushë çdo ditë një enë për përzierjen e ushqimit jashtë hambarit me silazh misri. Një shtyllë spirale përçon silazhin e misrit përmes një sistemi tubash përgjatë hambarit përafërsisht 100 m. Duke qenë se hapjet vendosen çdo 2-3 m në sistemin e tubacioneve, silazhi i misrit, por edhe materiale të tjera si kokrrizat e grurit apo kashtës, bien të shpërndara në mënyrë të barabartë nga tavani në zonën e gërvishtjes.

Procedura është në fakt shumë e thjeshtë, por efekti është i madh: nëse silazhi i misrit bie në tokë, është e pritshme që pulat të nxitojnë atje për ta konsumuar atë. Kokrrat shumë të tretshme pëzgjidhen fillimisht, në të njëjtën kohë pulat gërvishtin dhe lëvizin materialin shumë intensivisht. Si pjesë e sjelljes së marrjes së ushqimit, pula shpenzon shumë kohë duke gërvishtur dhe gërvishtur ushqimin e shtruar në tokë. Kjo sjellje e kërkimit dhe marrjes së ushqimit minimizon rrezikun e çrregullimeve të sjelljes.

Planifikohet që shpendët të vihen në lëvizje në orët e pasdites, kur vendosja e vezëve të përfundojë në orën 14:00. Ka mundësi, që aktiviteti teknik të fillojë për herë të dytë rreth orës 16 ose 17.

Skeptikët në fushën e të ushqyerit të shpendëve ndoshta do të argumentojnë se silazhi i misrit po zëvendëson ushqimin e përbërë dhe shpendët nuk po marrin më mjaftueshëm aminoacide thelbësore dhe energji.

Studimet nga Danimarka në bashkëpunim me studiuesit nga Celle (D) kanë qenë në gjendje të tregojnë, se pulat që janë ushqyer me 50 g silazh misri, përveç ushqimit përkatës, kanë ngrënë edhe 118 g ushqim.

Grupi i krahasimit pa shtimin e silazhit të misrit kishte një konsum ditor të ushqimit prej 130 g vakt për shpend në ditë. Një tufë prej 15,000 pulash për vezë mund të përpunojë rreth 750 kg silazh misri çdo ditë. Kjo korrespondon me një konsum vjetor prej 270 tonësh. Në praktikë, një konsum të llogaritur prej 10 g silazh misri për shpend në ditë, konvertohet në 150 kg në ditë dhe 54 ton në vit.

Mund të supozohet se efekti acidik i silazhit të misrit ndihmon në shtypjen e çdo mikrobi koliform në traktin tretës, sepse ushqimi i acidifikuar stabilizon zorrët.

Ka edhe përfitime të tjera të ushqyerjes me silazh misri. Pulat mund të zgjedhin individualisht atë që preferojnë në momentin e silazhimit të misrit: kokrrat e misrit ose përbërësit e fibrave të papërpunuara. Në kopshte (mbajtje të lirë) shpendët mund të lëvizin dhe të kërkojnë ushqim. Menjëherë pasi zogat janë vendosur pranë pulave të vezëve, shpendëve u jepet akses në kopësht. Zogat normalisht nuk mundën të vrapojnë deri në 3 javë, njëkohësisht kopshti pasurohet me silazh misri, në mënyrë që të tërheqë një numër sa më të madh zogash për t'i mbajtur ato në aktivitet.

Sa të larta janë kostot e investimit?

Kostot e investimit për një sistem teknik siç përshkruhet më sipër kapin vlerën nga 30,000 deri në 40,000 euro për 20,000 pulat e vezëve. Invenstimi është i madh, por nëse merret parasysh ngarkesa e minimizuar e punës dhe angazhimi i qëndrueshëm, intensiv dhe miqësor ndaj shpendëve me performancë më të mirë nëpërmjet zhvillimit të reduktuar të çrregullimeve të sjelljes, ia vlen për kompanitë më të mëdha.

Përveç mekanizimit më të shtrenjtë të administrimit të silazhit të misrit, një tjetër fermer për pula vezësh tashmë po vendos silazhin e misrit duke përdorur një lopatë për shpërndarjen e ushqimit.

Një tjetër mundësi është sjellja silazhit të misrit në baleta të vogla. Nëse kontraktorët do të ishin në gjendje të shtypnin baletat e vogla, kompakte, ato mund të vendoseshin më pas në zonat e caktuara për pulat e vezëve duke përdorur një sistem të automatizuar. Gjithashtu duhet t'i kushtohet vëmendje përdorimit jo vetëm të silazhit të misrit si material aktiviteti, por edhe silazhit të plotë të bimëve, barit të shkurtër të kullotave, karrotave, kërcellit ose patateve.

Ajo që mbetet për t'u theksuar: Silazhi i misrit për pulat e vezëve duket të jetë një risi e qëndrueshme dhe miqësore me shpendët, në të cilën shpendëve u jepet një zgjedhje e ushqimit në kopshtet dimërore. Efekti acid, vlera e ushqimit, si edhe efekti i fibrës së papërpunuar luajnë një rol të rëndësishëm në silazhin e misrit. Shpendët duhet të mësohen me këtë lloj ushqimi që në moshë të re. Silazhi i misrit ka veti promovuese të shëndetit, nuk e zëvendëson domosdoshmërisht ushqimin e përbërë dhe sigurisht që do i mbajë në aktivitet pulat e vezëve.

Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

13. MASAT PËR NJË CILËSI OPTIMALE TË GUASKËS SË VEZËS

Përpunuar nga Kristian Maka

Programi i dritës si dhe të ushqyerit e pulave luajnë rol të rëndësishëm në cilësinë e vezëve, përveç gjenetikës, shëndetit të kafshëve dhe menaxhimit të stallës.

Prodhimi i vezëve rrit nevojën e pulave për kalcium, por në të njëjtën kohë me kalimin e moshës përthithja e kalciumit nga kockat e gjata zvogëlohet. Rritja e përmasave të vezëve të thyera dhe të plasaritura zvogëlon numrin e vezëve të tregtueshme dhe rrjedhimisht të ardhurat.

Deficitet në qëndrueshmërinë e guaskës rriten drejt fundit të periudhës së prodhimit. Masat për përmirësimin e kësaj situatë duhen marrë shumë më herët. Funkcionaliteti i metabolizimit të kalciumit ndikohet ndjeshëm gjatë zhvillimit të trupit të pulës kur mbushen depot e kalciumit. Përpjekjet aktuale për të zgatur periudhën e shtrimit përtej javës së 72-të të jetës, po përqendrohen në masat për të siguruar cilësi optimale të guaskës.

Rekomandohen masat e mëposhtme për të përmirësuar cilësinë e guaskës, përveç përdorimit të qëndrueshëm dhe korrekt të ushqimit fillestar: Një zhvillim i peshës trupore gjatë fazës së rritjes dhe shtrimit të hershëm sipas specifikimeve të synuara, në këtë kohë krijohen bazat për rezervat e kalciumit në trup ndërsa një metabolizëm funksional i kalciumit krijohet në fazën e vonë të shtrimit. Kushtojini rëndësi përqendrimit optimal të kalciumit për çdo fazë të ushqimit, me përmasat e duhura të gurëve në mënyrë që të përshtatet shpejtësia e rrjedhës me nevojën dhe situatën metabolike. Sipas kësaj, në varësi të fazës së të ushqyerit dhe moshës në rritje të shpendëve, 70 deri në 85% e gurit duhet të jetë me strukturë të trashë.

Të ushqyerit ndikon në stabilitetin e guaskës dhe peshën e vezëve. Për shembull, duhet të shmanget ngrënia selektive dhe të sigurohet një furnizim i mjaftueshëm i vitaminës D3 (2500 IU/kg), ndonjëherë edhe me forma të vitaminës "Hy-D".

Duhet t'i kushtohet vëmendje zëvendësimit të pjesshëm të gurëve si një burim kalciumi me burime organike, të disponueshme në format kalciumi, butirat kalciumi ose laktat kalciumi. Shmangni klorurin e tepërt (nën 2 g/kg LAF) dhe zëvendësoni klorurin e natriumit me të tjera burime të natriumit, si bikarbonat natriumi.

Gjithashtu i rëndësishëm është furnizimi me mikroelementë, zink dhe mangan, përdorimi i vajit për shëndetin e mëlçisë duke përfshirë shtimin e kolinës + betainë, si dhe acidet organike ose ekstraktet fitogjene për shëndetin e zorrëve. Rekomandohet gjithashtu ofrimi i guaskave të gocave të detit si një burim kalciumi me furnizim të ngadaltë. Për të reduktuar rritjen e peshës së vezëve në periudhën e fundit të shtrimit, duhet të reduktohet përmbajtja e acidit linoleik, ndoshta duke zëvendësuar proteinat e sojës me proteinat e rapës. Gjithashtu merrni parasysh imunoprofilaksinë kundër të gjitha sëmundjeve me pasoja negative për stabilitetin e lëvizshëm, bronkitin infektiv dhe EDS, si dhe vaksinimin kundër serotipeve QX dhe 4/91 të TB.

Pesha e vezës

Për shitësit me pakicë, fokusi është në një numër maksimal vezësh me peshë mesatare, ndërsa tregtarët e drejtpërdrejtë kanë nevojë për një përqindje të lartë të vezëve L dhe mund të arrijnë të ardhura relativisht të larta me vezët XL. Vezët S nuk pëlqehen për treg. Për të arritur zhvillimin e dëshiruar të peshës së vezës, rekomandohen masat e mëposhtme të ushqyerjes dhe menaxhimit të zogave:

Për vezë me peshë të lartë përdoret stimulimi i vonshëm i dritës me një program të ngadaltë të rritjes; për vezë me peshë mesatare përdoret stimulimi i dritës me një program të shpejtë të rritjes; ka dallime në programin e dritës midis pulave të bardha dhe kafe. Zogat e lehta dhe të vogla sjellin % të lartë të vezëve S. Zogat e mëdha kanë një avantazh shtesë, sepse prodhojnë vezë me peshë më të lartë. Rritja e peshës së vezës arrihet përmes përqendrimeve të larta të metioninës, cistinës, acidit linoleik dhe energjisë në ushqim. Një përmbajtje e lartë e acidit linoleik (2%) në fillim të prodhimit ul përqindjen e vezëve me përmasa S. Përqendrimi i acidit linoleik zvogëlohet gjatë ushqyerjes me faza. Nivelet e larta të aminoacideve që përmbajnë squfur, veçanërisht metioninës, shërbejnë për të rritur peshën e vezës.

Ushqimi me faza të koordinuara ka një ndikim të madh në zhvillimin e peshës së vezëve, sepse nivelet e proteinave të papërpunuara, aminoacideve dhe acidit linoleik zvogëlohen në fazat e mëvonshme të të ushqyerit (2 + 3). Prodhuesit shmangin dhe parandalojnë një rritje të madhe të padëshiruar të peshës së vezëve.

Përmbledhje

Ndikimi i të ushqyerit në peshën e vezëve qëndron kryesisht në përmbajtjen e acidit linoleik, metioninës dhe energjisë. Për të siguruar qëndrueshmëri të lartë të lëvozhgës janë të nevojshme masat speciale për një metabolizim funksional të kalciumit. Efekte pozitive kanë: përqindjet e larta të gurëve gëlqerorë (kalcium), një strukturë ushqimore homogjene dhe sigurimi i burimeve shtesë të kalciumit, siç janë lëvozhgat e gocave të detit.

Për më shumë informacion:



Q F Qendra e Formimit
P B Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

14. PËRPARËSITË E PËRDORIMIT TË BONVITAL

Përpunuar nga Kristian Maka

Çrregullimet e shëndetit të zorrëve konsiderohen si shkak kryesor i humbjeve të kafshëve dhe si pasojë edhe i humbjeve ekonomike. Mikroorganizmat e gjallë përdoren në ushqimin e kafshëve si probiotikë, për të stabilizuar dhe stimuluar florën e zorrëve. Ato përmirësojnë marrjen e ushqimit dhe tretjen e ushqimit, në këtë mënyrë stimulohet vitaliteti dhe rritja e kafshëve.

Eksperienca të shumta në fushën e të ushqyerit kanë demonstruar përfitimet e probiotikut Bonvital në majmërinë e zogjve. Bonvital është miratuar që nga viti 2006 dhe vlerësimet konfirmuan efektivitetin e tij në rritjen, tretjen e ushqimit dhe shëndetin në majmërinë e zogjve.

Eksperimentet A dhe B të paraqitura në Tabelën 1 u kryen në stacionin mësimor dhe eksperimental për kafshët e vogla në Kitzingen, eksperimentet C dhe D u kryen në fermën mësimore dhe kërkimore Ruthe.

Broilerat u mbajtën në kushte reale, në sistem dysheme, me ajrim me presion negativ dhe ftohje me spërkatje. Baza e përzjerjeve të ushqimit u përdor një racion gruri dhe soje. Përzjerjet korrespondonin me kërkesat për energji dhe lëndë ushqyese të zogjve. Ushqimi fillestar dhe ushqimi për majmëri përmbante një kokcidiostat. Bonvital me përbërësin aktiv *Enterococcus faecium* (DSM 7134) iu shtua ushqimit përkatës në sasinë e treguar në figurën 1. Ushqimet e plota ishin në formë mielli (A, B) dhe të peletuara (C, D).

Rezultatet e eksperimentit janë bindëse

Parametrat e vlerësuar:

- zhvillimi i peshës së gjallë
- konsumi i ushqimit
- tretja e ushqimit
- humbjet e kafshëve.

Tabela 2 përmbledh një pjesë të rezultateve të testit. Përdorimi i Bonvital shfaq efekte pozitive gjatë gjithë fazës së majmërisë.

Eksperimentet A dhe B duke marrë parasysh strukturën miellorë të ushqimit, treguan një nivel të lartë shtimi.

Eksperimenti A probiotiku ndikoi pozitivisht në peshën trupore, shtimin e peshës dhe tretjen e ushqimit.

Në eksperimentin B, përdorimi i mikroorganizmave probiotikë pati një efekt pozitiv në tretjen e ushqimit. Në grupin me Bonvital, konsumi i ushqimit u rrit me 5% (eksperimenti A) dhe 2% (eksperimenti B). Humbjet u reduktuan nga 1.6% në kontroll në 0.8% (Eksperimenti A).

Eksperimenti C tregoi një rritje më të madhe dhe si rezultat një peshë trupore më të lartë në grupin probiotik (2.18 kg) krahasuar me kontrollin (2.05 kg). Në eksperimentin D, përdorimi i probiotikut çoi në tretje më të mirë të ushqimit (-2.1 %), Kriteri ekonomikisht më i rëndësishëm në majmërinë e zogjve, si dhe humbjet më të ulëta (-0.5%).

Në eksperimentet e zhvilluara, u demonstrua në një dozë prej $1,0 \times 10^9$ CFU/kg, një ndikim i verifikuar statistikisht i Bonvital në parametrat e performancës së zhvillimit të peshës trupore, konsumit dhe tretjes së ushqimit.

Në fazën e parë të majmërisë u arritën rezultate shumë të mira të peshës trupore, rritjes dhe tretjes së ushqimit - një tregues i qartë i efektit të fortë të Bonvital te shpendët e reja, me një sistem imunitar të zhvilluar jo mjaftueshëm.

Ekperienca në praktikë konfirmon rezultatet e eksperimentit: Bonvital po vendos standarde të reja në majmërinë e zogjve.

Eksperimenti	Vendi	Viti	Nr. i Broiler	Koha
A	Kitzingen1)	2002	4.000	32 Ditë
B	Kitzingen1)	2003	4,000	33 Ditë
C	Ruthe2)	2005	18,300	36 Ditë
D	Ruthe2)	2005	18.500	36 Ditë

Tab. 1: Eksperimentet ($1,0 \times 10^9$ KBE BONVITAL/kg vs. Kontrolli

1) *Instituti Shtetëror Bavarez për Mbarështimin e Kafshëve, stacion mësimor dhe eksperimental për kafshët e vogla në Kitzingen, Dr. Damme*

2) *Ferma mësimore dhe kërkimore Ruthe e Universitetit të Hanoverit, Prof. Dr. Kamphues*

	Eksperimenti	Kontroll	1,0 x 109 KBE Bonvital
Rritja (kg)	A	1,36	1,46
	C	2,01	2,14
Shtimi i ushqimit	B	1,73	1,70
	D	1,56	1,52
Humbjet (%)	A	1,60	0,80
	D	3,10	2,60

Tab. 2: Parametrat e performancës së broilerave

Për më shumë informacion:



Q F Qendra e Formimit
P B Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk


Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

15. MENAXHIMI I SHTRJËS- PËRGATITJA E DUHUR PËR VJESHTËN!

Përpunuar nga Kristian Maka



“Përmbajtja e lagështisë së shtrojës ndikon në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin dermatitit të këmbëve!”

Ky është përfundimi i arritur nga grupi i punës i drejtuar nga Prof. Kamphues nga Universiteti i Mjekësisë Veterinare (TIHO) në Hanover.

Pavarësisht nga ushqimi dhe lloji shtrojës, përmbajtja e lagështisë së shtrojës, sipas TIHO Hanover, është një faktor i rëndësishëm për shëndetin e këmbëve të pulave: ushqimi i ekuilibruar dhe shtroja e mirë japin një kontribut vendimtar në rregullimin e përmbajtjes së lagështisë.

Në vjeshtë duhet marrë parasysh se lagështia shtohet, kur mjegulla është përsëri e pranishme rreth stallës. Megjithatë, ende nuk ka pajisje praktike për përcaktimin e shpejtë të lagështisë aktuale të shtrojës. Si pasojë, përshtypja subjektive dhe përvoja personale vendosin se si trajtohet shtroja dhe kur duhet hedhur një shtresë tjetër.

Mos u gënjeni nga sipërfaqja e shtrojës, sepse shpesh lagështia është prezente në shtresat më të thella të saj. Pulat dhe broilerat e fermës janë në kontakt të vazhdueshëm me shtrojen dhe cilësia e dobët e saj mund të ndikojë në shëndetin e shpendëve.

Për menaxhimin optimal të shtrojës duhet të merren parasysh kritere të ndryshme:

Rregullimi i lagështisë

Qëllimi kryesor i shtrojës është të thithë lagështinë dhe ta lëshojë atë në ajër sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që sipërfaqja e shtrojës të mbetet e thatë.

Në të kundërt formohen arna të lagura, në këtë rast shtroja është mbingarkuar nga lagështia. Studimet nga Youssef et al., 2011 tregojnë se lignoceluloza thahet më shpejt dhe për këtë arsye është më e përshtatshme se ashklat e drurit dhe madje më mirë se kashta e copëtuar.

Optimizimi i rrjedhës së ajrit

Në vjeshtë, lagështia luan një rol të madh. Të dhënat janë siguruar duke përdorur një regjistruer të dhënash (Datalog) për monitorimin e vazhdueshëm të temperaturës dhe lagështisë. Regjistruesit e të dhënave dhe softueri ndihmojnë për të bërë ndryshime afatshkurtra dhe afatmesme të ventilimit dhe ngrohjes. Mbi rrjedhjen optimale të ajrit në stallë ka vite të tëra njohurish të specializuara. Kur ndërtohet stalla, përdoret një softuer planifikimi për të llogaritur përdorimin optimal të teknologjisë së ventilimit. Identifikimi i vendndodhjes së burimeve problematike të fluksit të ajrit në stallë, teknologjia, ndriçimi etj, janë të rëndësishme.

Këmbyesit e nxehtësisë ofrojnë shërbime të vlefshme, sepse përveç efektit pozitiv të kursimit të energjisë, ato reduktojnë lagështinë dhe në këtë mënyrë mundësojnë që shtroja të zgjasë më gjatë.

Kontrolli i burimeve të nxehtësisë

Për të plotësuar kërkesat për ngrohje të zogjve të vegjël, shumica e stallave ngrohen me ngrohës me gaz. Ngrohja e stallave bosh të shpendëve, funksionon pa problem brenda pak ditësh dhe sistemi është i testuar. Djegia e drejtpërdrejtë e gazit prodhon shumë CO dhe ujë, i cili çlirohet në stallë; 1 kg gaz natyror prodhon mbi 2 kg ujë, i cili duhet të hiqet nga stalla nëpërmjet ventilimit.

Ngrohësit me ajër të ngrohtë si p.sh. konvertorët e thajnë ajrin, prandaj duhet të mbahet në vëmendje lagështia e ajrit, sepse për zogjtë, ajri shumë i thatë mund të jetë i dëmshëm për traktin respirator dhe mukozën. Ajri duhet të lagështohet, nëse është e nevojshme.

Ekziston edhe teknologjia moderne e djegies së gazit, që bën të mundur përdorimin e djegies indirekte për të çliruar CO dhe ujin jo në stallë, por e nxjerr menjëherë jashtë nëpërmjet tubave.

Të ushqyerit dhe uji i pijshëm

Uji i pijshëm dhe ushqimi janë faktorë vendimtarë për shëndetin e kafshëve. Rekomandohet të respektohen rregullat bazë të higjienës gjatë ruajtjes së ushqimit, të ushqyerit dhe ujit të pijshëm. Nëse tretja është jashtë ekuilibrit, duhet të merren masa të shpejta, të cilat diskutohen paraprakisht me veterinerin dhe konsulentin e ushqimit. Nëse raporti i marrjes së ushqimit me marrjen e ujit ndryshon ndjeshëm, atëherë feçet në mënyrë të pashmangshme do të bëhen më të lagura. Feçet e lagura gjatë disa ditëve janë në shumë raste arsyeja pse mbetjet nuk mund të thahen ose krijohen kore që nuk mund të thithin më lagështi. Të gjitha masat që i shërbejnë shëndetit të kafshëve dhe stabilizojnë tretjen janë ekonomike – edhe ato që ndikojnë në jetëgjatësinë e shtrojës.

Në praktikë, për të stabilizuar tretjen e kafshëve përdoren një numër aditivësh në ujin e pijshëm dhe ushqimin. Gjatë shumë viteve acidet organike kanë vërtetuar vlerën e tyre për kontrollin e vlerës së pH në ujin e pijshëm dhe në stomakun e zogjve. Acidi butirik, vajrat esenciale, ekstraktet bimore përdoren për furnizimin e vileve të zorrëve të holla me energji shtesë.

Fibrat dietike janë shumë të rëndësishme për shpendët. Lignoceluloza, si një fibër me cilësi të lartë, pa rrezik kontaminimi me mykotoksina ose baktere të tjera, është një komponent kyç për një fermentim funksional në zorrë, nxit shpejtësinë e kalimit dhe thithjen e ujit nga zorrët, kjo i bën feçet më të thata.

Magazinimi i shtrojës

Hambari i ruajtjes së kashtës duhet të jetë i disponueshëm për gjatë gjithë vitit dhe duhet të kontrollohet rregullisht për brejtës. Në verë para korrjes së grurit është koha e duhur për të pastruar dhe nëse është e nevojshme, për të dezinfektuar hambarin e kashtës. Mund të konsiderohet edhe instalimi i kutive të karremit për brejtësit dhe për të shmangur zogjtë, të cilët janë bartës të mundshëm të sëmundjeve.

Zgjidhja më e pastër është kur shtroja vjen nga një prodhim i kontrolluar, është e paketuar mirë dhe dorëzohet e freskët përpara çdo cikli të rritjes ose majmërisë. Kjo kursen kosto të ndryshme transporti dhe magazinimi për kashtën. Ideale për përpunim është lënda e parë e drurit, e cila ofrohet në formën e ashklave të drurit, ose të bluar imët si lignocelulozë. Gjatë prodhimit të shtrojës nga lignoceluloza, druri nxeht disa herë, në mënyrë që produkti të mos jetë bartës i mundshëm i mykut ose baktereve të padëshiruara.

Kostot

Kostot e blerjes së shtrojës dhe materialit për ngrohje mund të përcaktohen shumë lehtë. Ju gjithashtu mund të llogarisni edhe kostot e energjisë elektrike për ventilim. Me pak më shumë "ngrohje" dhe "ajrim" mund t'i kurseni vetes spërkatjet e herëpashershme, dhe si pasojë edhe kohën e punës. Shtroja, sa më shpejt e më mirë ta absorbojë dhe ta çlirojë lagështinë, aq më i pakët do jetë përdorimi i një shtroje të re, gjë që kursen kostot në stallë.

Për më shumë informacion:



Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

Website: www.ap.com.al

16. TË USHQYERIT E PULAVE PËR VEZË

Përpunuar nga Jon Zeneli

Performanca nuk është i vetmi faktor që ka rëndësi në prodhimin e vezëve. Gjithnjë e më e rëndësishme është cilësia e lartë e vezëve. Për një konsumator të kënaqur duhet: freski, shije, ngjyra e duhur e të verdhës, e bardha e vezës cilësore dhe lëvozhgë e qëndrueshme dhe e pastër. Përdorimi i përzierjeve minerale moderne, shumë efikase, bën të mundur prodhimin e vezëve me cilësi më të lartë.

Teknikat e të ushqyerit në mbarështimin e pulave për vezë janë të përshtatura për cilësinë e vezëve të jashtme dhe të brendshme.

Cilësia e jashtme e vezës - lëvozhga dhe pesha

Klasa A- lëvozhga duhet të jetë e pastër dhe e padëmtuar. Nëse lëvozhga e vezës është e dëmtuar, ekziston rreziku i kolonizimit mikrobik.

Lëvozhga e vezës përbëhet nga 98% substanca inorganike, kryesisht CaCO₃. Pjesa e mbetur prej 2% janë komponime proteinike. Meqenëse pula nuk ka një depozitë kalciumi në mitër, ai duhet të merret nëpërmjet ushqimit. Shumica e Ca merret direkt nga ushqimi nëpërmjet qarkullimit të gjakut, vetëm rreth 20% shpërndahet nga skeleti.

Procesi i formimit të lëvozhgës së vezës përcaktohet nga estrogjeni, ndërsa hormoni paratiroid dhe kalcitonin janë përgjegjës për nivelin e Ca në gjak. Vitamina D stimulon një proteinë Ca-lidhëse, e cila thith Ca nga zorrët dhe e transporton me anë të qarkullimit të gjakut.

Kristalizimi i mineraleve kontrollohet kryesisht nga enzima anhidraza karbonike, e cila reagon ndaj vlerës së pH, rrjedhimisht kjo shpjegon efektin negativ që ka rritja e përmbajtjes së klorurit në ushqim, në stabilitetin e lëvozhgës.

Procesi i formimit të lëvozhgës së vezës zgjat rreth 20 orë, prandaj është e rëndësishme një shpërndarje e vazhdueshme e Ca në mitër. Pulat duhet të kenë akses në ushqim gjatë gjithë kohës, një pjesë e karbonatit të kalciumit në racion mund të zëvendësohet me lëvozhgën e midhjeve, si një burim kalciumi me veprim të ngadaltë. Në këtë mënyrë mishi i pulës furnizohet me kalcium për një periudhë më të gjatë kohe.

Studimet e fundit nga Franca kanë treguar se pulat për vezë, që marrin një orë dritë gjatë natës konsumojnë ushqim shtesë, niveli i Ca në gjak rritet dhe stabiliteti i lëvozhgës përmirësohet.

Për sa Ca ka nevojë pula?

Përmbajtja e Ca në ushqim duhet të jetë ndërmjet 3,5% dhe 4% Ca (nga fundi i periudhës së shtrimit). Zakonisht përdoret karbonati i kalciumit, në masën 8-9% në racion. Struktura e tij nuk duhet të jetë shumë e imët në mënyrë që shpërndarja të jetë e barabartë dhe mos precipitohet në fund të trogut. Të gjitha mineralet dhe vitaminat e tjera duhet t'i shtohen ushqimit në sasi të mjaftueshme, kjo sigurohet nga përzierja me premikset 2% nga Schaumann (Ovital Intensiv, Tri-Ovital ose Tri-Ovital Mais).

Problemet me cilësinë e lëvozhgës së vezës mund të lidhen edhe me kushtet e pafavorshme të kapanonit. Pulat që janë të ekspozuara ndaj infektimit nga bakteret ose rrymave priren të jenë të stresuara dhe si pasojë vezët mund të godasin ashpër rritjen. Vendosja jo e duhur e pajisjeve të grumbullimit të vezëve mund të rezultojë gjithashtu në plasaritje të vezëve ose vezë me çarje të lehta.

Stabiliteti i lëvozhgës përkeqësohet zakonisht në verë, kur ekspozohet ndaj nxehtësisë së shtuar. Për shkak të rritjes së ritmit të frymëmarrjes, kafshët lëshojnë më shumë CO₂, i cili si pasojë nuk është më i disponueshëm për ndërtimin e lëvozhgës.

Aspekte të tjera të rëndësishme të cilësisë së jashtme të vezës janë pesha e vezës dhe pastërtia e saj. Në përgjithësi, vezët duhet të mbledhen të paktën një herë në ditë ose të shpendët problematike edhe më shpesh, kjo siguron që vezët të mos ndoten.

Pesha e vezës përcakton të ardhurat e fermerit. Shpesh synohet një peshë veze prej 60 g, pasi me këtë peshë mund të pritët sukcesi më i mirë i fekondimit.

Zogat, të cilat nuk po marrin ende ushqim të mjaftueshëm, kanë nevojë për më shumë kohë për të arritur peshën e duhur të vezëve. Një përmbajtje më e lartë e metioninës prej 0.36% në fazën fillestare është vërtetuar si e suksesshme.

Nivelet e larta të proteinave të papërpunuara të acidit linoleik dhe një stimulim i marrjes së ushqimit kanë gjithashtu një efekt pozitiv në peshën e vezëve. Shpendët me peshë më të madhe trupore, në fillim të prodhimit ushqehen në atë mënyrë, që të rrisin peshën e vezëve gjatë gjithë periudhës së prodhimit.

Mbarështuesit e pulave nuk mund të ndikojnë në ngjyrën e lëvozhgës së vezëve, e cila është e rëndësishme vetëm për vezët kafe, dallimet në ngjyrë janë në varësi të origjinës së pulës.

Cilësia e vezës - freskia, shija dhe ngjyra e së verdhës

Freskia e vezës është një veçori e rëndësishme për konsumatorin, prandaj, vezët duhet të grumbullohen sa më shpesh të jetë e mundur. Nëse veza ruhet për një periudhë më të gjatë kohore ose bie në kontakt me baktere, ajo mund të marrë një erë të pakëndshme. Ruajtja e ftohtë në një dhomë të veçantë parandalon vjetërimin e vezës dhe ndikimin e faktorëve të tjerë.

Fig.1: Ndikime pozitive dhe negative në parametra të ndryshëm të cilësisë së vezëve

Stabiliteti i lëvozhgës	
+	<ul style="list-style-type: none"> • Ca dhe vitamina të mjaftueshme • shpërndarje e qëndrueshme e Ca • Ca i strukturuar • dritë shtesë gjatë natës
-	<ul style="list-style-type: none"> • përmbajtje e lartë Cl në ushqim • pula jo të qeta • pajisje jo të mira të stallës • Nxehtësia
Pesha e vezës	
+	<ul style="list-style-type: none"> • Përmbajtja e metioninës 0,36 % në fazën fillestare • përmbajtje e lartë e proteinave të papërpunuara dhe acidit linoleik • stimulimi i konsumit të ushqimit • peshë e lartë trupore në fillim të prodhimit
Freskia	
+	<ul style="list-style-type: none"> • pastërti në stallë • grumbullimi i shpeshtë i vezëve • Ruajtja e vezëve në një ambient të veçantë, të freskët
Shija	
-	<ul style="list-style-type: none"> • Të ushqyerit me farat e rapës dhe miell peshku


E verdha e vezës

+

- Ushqim mineral i dozuar saktësisht
- Misër

-

- Krimb
- Administrimi i vitaminës A



Vezët e shijshme dhe të shëndetshme janë rezultat i një koncepti të të ushqyerit me drithëra dhe suplemente proteinike

Te pulat ngjyrë kafe të ushqyerit me farat e rapës ose miellin e peshkut mund të prodhojnë një shije peshku. Njollat e gjakut dhe të mishit, të cilat perceptohen si shumë të pakëndshme nga konsumatori, janë veçanërisht të zakonshme tek pulat kafe. Ato nuk mund të ndikohen nga të ushqyerit. Vetëm gjenetika mund të ndihmojë në këtë rast.

E verdha duhet të jetë e verdhë e qartë. Përzjerja e premikseve duhet të realizohet me një dozë të saktë (p.sh. Ovital-Intensive 2%), sepse drithrat nuk përmbajnë pothuajse asnjë agjent ngjyruës, me një përjashtim të misrit. Ngjyra e së verdhës mund të përkeqësohet pas administrimit të antioksidantëve, si dhe pas administrimit të preparateve vitaminike, pasi vitamina A konkurron me karotenoidet në përthithje.

Përdorimi në industri

Pothuajse 12% e prodhimit total të vezëve përdoret në industri. Membrana e së verdhës së vezës ka një rëndësi të madhe në ndarjen mekanike të të verdhës nga albumina, ajo parandalon përzjerjen e të bardhës me të verdhën.

Përveç dallimeve gjenetike midis origjinës, freskia e vezës është shumë e rëndësishme. Nëse ruhet në një ambient të ngrohtë ose shumë gjatë, forca e membranës zvogëlohet - ndarja mekanike nuk është më e mundur.

Në rastin e të bardhës së vezës, cilësia e së cilës përcaktohet shumë nga gjenetika, është i rëndësishëm dhe viskoziteti.

Me konceptet moderne të të ushqyerit dhe menaxhimit e synuar, cilësia e vezëve mund të ndikohet pozitivisht në të gjitha fushat. Një prodhim i orientuar nga tregu dhe konsumatori siguron konkurrencë dhe të ardhura të kënaqshme.

Për më shumë informacion:



Q F Qendra e Formimit
P B Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

17. DEVIJIMET NGA SJELLJA NORMALE E SHPENDËVE

Përpunuar nga Jon Zeneli

Kushtet e këqija mjedisore mund të mposhtin përshtatshmërinë e shpendëve dhe të çojnë në çrregullime të sjelljes.

Një çrregullim i sjelljes është një devijim i rëndësishëm dhe i vazhdueshëm nga sjellja normale që lidhet me mënyrën e mbarështimit, përditshmërinë. Këto sjellje nuk ndodhin në kushte normale.

Çukitja e pendëve dhe kanibalizmi lidhen kryesisht me pulat, por po vërehen gjithnjë e më shumë edhe tek gjelat, rosat dhe herë pas here patat. Shpendët reagojnë në mënyra të ndryshme ndaj çukitjes së pendëve dhe kanibalizmit.

Faktorët që çojnë në çrregullime të sjelljes janë të shumtë. Nëse shpendët janë të kufizuara në sjellje gjatë përditshmërisë, disa faktorë bashkohen, kufizimet bëhen të mëdha dhe ato në mënyrë të pashmangshme stresohen dhe ekuilibri i sjelljes prishet.

Shkaktarët e çrregullimeve të sjelljes nuk mund të analizohen plotësisht në të gjithë kompleksitetin e tyre, pasi nuk dihen të gjitha ndërveprimet e mundshme ndërfaktoriale.

Një nga shkaktarët e çukitjes së pendëve është mënyra e gabuar e të ushqyerit. Kushtet e rritjes së përshtatshme për shpendët janë një komponent shumë i rëndësishëm për suksesin e mbarështuesve të pulave.

Vëmendje duhet t'u kushtohet gjelave të detit në javët e para të rritjes që të mos çukisin njëri-tjetrin. Metodatat që stimulojnë largimin e vëmendjes ndaj njëri-tjetrit janë mjaft të përshtatshme. Në këtë mënyrë vëmendja përqëndrohet te të kërkuarit e ushqimit dhe sjellja e çukitjes stabilizohet.

Një ambient i larmishëm është shumë i dobishëm, në kushtet e duhura të klimës, moshës apo gjendjes së shpendëve. Në lidhje me agresivitetin midis llojit, racat e pastra të gjelit të detit thuhet se janë më të tolerueshme se llojet hibride konvencionale. Gjelat arrijnë pjekurinë seksuale gjatë majmërisë afatgjatë, gjë që çon në shqetesime më të mëdha.

Shpendët e ujit

Çukitja e pendëve dhe kanibalizmi janë vënë re edhe te llojet e rosave Cairina. Një nga arsytet është mospërshtatja e kushteve me habitatin e tyre natyror, ujin dhe tokën. Faktorë të tjerë seriozë janë hapësirat e kufizuara të rezervatit dhe kequshqyerja.

Masat parandaluese

Edhe në kushte optimale, nuk mund të përjashtohet plotësisht shfaqja e çukitjes së pendëve dhe kanibalizmit. Në çdo rast, është e rëndësishme që të analizohen shkaqet dhe të eliminohen burimet e stresit në një fazë të hershme.

Gjenetika

Midis linjave të ndryshme hibride ka dallime të rëndësishme në agresivitetin midis specieve (llojet e ndryshme të pulave). Mbarështimi bazohet në thelb në performancën e pjelljes dhe të majmërisë, sjellja sociale që është e rëndësishme për mbarështimin e pulave për vezë, si p.sh. përputhshmëria e shpendëve me njëra-tjetrën, nuk është marrë mjaftueshëm parasysh. Një nivel i lartë agresiviteti mund të ndodhë edhe në shpendët e të njëjtit lloj, kështu që aktualisht nuk ka asnjë faktor absolut (përveç performancës kryesisht të moderuar të shtrimit).

Natyrisht, që në fillim zogjtë e rinj duhet të kenë mundësinë të rriten në një mjedis të përshtatshëm. Bashkëpunimi ndërmjet mbarështuesit dhe fermerit luan një rol të rëndësishëm, në mënyrë që kushtet e mbarështimit të zogjve të korrespondojnë sa më shumë me rritjen e mëvonshme.

Të ushqyerit

Mungesa e ushqimit dhe mangësitë në furnizim me lëndë ushqyese (minerale [natriumi], aminoacide [metioninë], proteina) mund të shkaktojnë goditjen e pendëve. Të ushqyerit në kapanon duhet të kontrollohet për një përmbajtje të mjaftueshme lëndësh ushqyese dhe të plotësohet nëse është e nevojshme.

Kur shpendët ushqehen me miell ose pelet, nevojat thelbësore të sjelljes së të ushqyerit nuk përmbushen. Karotat, rrepat, sana, foragjeret e gjelbra, barishtet, si dhe guri gëlqeror dhe kripa rekomandohen si ushqim shtesë për të parandaluar goditjen e puçlave. Nëse pulave nuk u sigurohet ushqim i mjaftueshëm, kjo çon në një mungesë indirekte ose relative të lëndëve ushqyese, me reagimet përkatëse që pasojnë.

Shtroja duhet të mbahet e thatë dhe jo e ngjeshur. Përveç kësaj, një shtrojë me tre shtresa, me banjë rëre të paktën 10cm të thellë, duhet të vendoset në zonën e gërvishtjes. Banjat me rërë dhe pluhur u mundësojnë pulave dhe gjelave të kujdesen për trupin dhe puçlat e tyre, gjë që është shumë e rëndësishme për mirëqenien e tyre (p.sh. ektoparazitët).

Shpendët e ujit kanë nevojë për ambiente të përshtatshme banje. Aktiviteti i shpërndarjes dhe kërkimi i ushqimit inkurajohet dhe zgjatet duke shpërdarë përditë kokrra të drithërave nëpër shtrojë. Kjo kufizon shfaqjen e „çukitjes së pendëve“.

Klima në stallë

Një klimë e mirë e qëndrueshme (lagështia relative prej 60 deri në 80 %, si dhe ajri me emetim të ulët dhe jo shumë të ngrohtë) redukton shfaqjen e çukitjes së pendëve. Heqjes së plehut organik dhe evakuimit të gazrave të dëmshëm duhet t'i kushtohet veçanërisht vëmendje. Furnizimi dhe shpërndarja e ajrit të pastër duhet të jetë e kontrollueshme. Në këtë kontekst duhen parë edhe mbetjet në zonën e gërvishtjes, veçanërisht në zonën e ngrohtë. Nëse kjo zonë është shumë e thatë, brenda stallës krijohet një sasi e madhe pluhuri, e cila gjithashtu duhet të stabilizohet nëpërmjet shkëmbimit të ajrit dhe/ose përmbajtjes së lagështisë në shtrojë. Një efekt i ngjashëm ndodh pas përdorimit dezinfektantit për të luftuar ektoparazitët.

Drita është një komponent bazë në blegtori. Megjithatë, duhet siguruar që drita të jetë indirekte ose e shpërndarë (xham akulli). Drita e mprehtë/drejtpërdrejtë (rrezet e diellit) mund të nxisë ndjeshëm çukitjen e pendëve. Zona e gërvishtjes duhet të jetë e ndriçuar, zona e ushqimit dhe e pirjes duhet të jetë mesatarisht e ndriçuar dhe zona e pushimit duhet të jetë pak e ndriçuar. Llambat me frekuencë të ulët janë mjaft të papërshtatshme për ndriçim, pasi dridhja është një burim stresi për pulat. Llambat me spektër të plotë janë provuar të jenë një burim i përshtatshëm drite.

Për më shumë informacion:



QF Qendra e Formimit
PB Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

18. MYK NË VEZËT E FRESKËTA

Përpunuar nga Kristian Maka

Sporet e mykut janë kudo në ajër. Në fazat e hershme, rritja e mykut nuk mund të shihet me sy të lirë. Myku bëhet i dukshëm vetëm kur disa hife (fije) formojnë micelën (rrjetë myku) dhe më pas shfaqen me ngjyra të ndryshme (lloje të ndryshme myku) në sipërfaqe.

Disa lloje myku, kur rriten, prodhojnë metabolitë toksikë të njohur si mykotoksina (p.sh. aflatoksinë). Aflatoxinat mund të hyjnë në zinxhirin ushqimor pa u vënë re nga syri i njeriut dhe të kontaminojnë ushqimin.

Myqet kanë nevojë për dy komponentë, që të shumohen lehtësisht: një furnizim të përshtatshëm me lagështi si , dhe nga ana tjetër, një burim lëndësh ushqyese si substanca organike (p.sh. yndyrna, proteina, karbohidrate), si ato që gjenden edhe në vezë.

Temperaturat optimale të rritjes janë midis 25°C dhe 35°C. Sipërfaqet me lagështi mund të përbëjnë një problem të madh për vezët e freskëta nëse profili i temperaturës nuk është konstant gjatë gjithë zinxhirit të transportit (nga magazinimi në kompani deri te konsumatori) ose nëse temperaturat rriten. Paletat e vendosura shumë afër njëra-tjetrës në dhomën e magazinimit mund të favorizojnë zhvillimin e mykut, sepse qarkullimi shumë i vogël i ajrit çon në një rritje të lagështisë.



Fig. 1: Myku në pjatë Petri




Fig. 2: Fijet e mykut në vezën e freskët

Testet mikrobiologjike kanë treguar se vezët e papërpunuara, ku shfaqet vizualisht myku i lëvozhgave nuk mund të përdoren as si vezë të freskëta, as si lëndë e parë për prodhimin e vezëve të ziera dhe/ose të lyera, as si lëndë e parë për prodhimin e produkteve të vezëve të lëngshme ose të thata, sepse hapat përkatës të prodhimit (proceset e gatimit dhe ngjyrosjes, proceset e pasterizimit) nuk janë të mjaftueshme për të vrrarë mykun. Vezët e mykura gjithmonë duhet të hidhen dhe nuk duhet të hyjnë në zinxhirin ushqimor.

Për të shmangur formimin e mykut në vezët e freskëta, duhet të respektohen kushtet e mëposhtme:

Temperatura duhet të mbahet sa më konstante gjatë gjithë zinxhirit të transportit ose temperaturat duhet të ulen nga fermeri te konsumatori.

Dhomat e ruajtjes së vezëve në stacionet e paketimit ose në impiantet e stampimit duhet të pajisen me ventilim.

Vezët duhet të ruhen në paleta në mënyrë të tillë që të jetë i mundur qarkullimi i mjaftueshëm i ajrit.

Regjistrimet ditore të vlerave të temperaturës dhe lagështisë për të kuptuar nëse klima e dhomës është e përshtatshme për ruajtjen e vezëve të freskëta.

Masat e mësipërme mund të ulin ndjeshëm rrezikun e zhvillimit të mykut në vezë të freskëta, kjo duhet të jetë në interes të të gjitha kompanive përgjatë zinxhirit.

Për më shumë informacion:

19. MATJA E DHOMËS SË AJRIT TË VEZËS


Përpunuar nga Kristian Maka

Standardet e tregtimit të vezëve parashikojnë që qendrat e paketimit duhet të pajisen me një matës të dhomës së ajrit të vezës. Në pamje të parë kjo tingëllon teknikisht shumë komplekse, por matja kryhet fare thjesht, me një matës. (Fig. 1).



Lartësia e dhomës së ajrit — një kriter cilësie

Kriteret e klasifikimit të cilësisë për vezët e kategorisë A janë të përgatitura qartë. Vetëm vezët e kategorisë A mund të paktohen ose shiten te tregtarët. Një kriter cilësor për shkallën e freskisë është lartësia e dhomës së ajrit, e cila nuk duhet të kalojë 6 mm. Në fund të vitet 1990, lartësia e dhomës së ajrit ishte treguesi i vetëm i shkallës së freskisë së vezëve, më pas u fut shënimi i datës së skadencës.



Krijimi i dhomës së ajrit

Matja e lartësisë së dhomës së ajrit është e vështirë, për vezët e freskëta të ditës, gjatë matjes përcaktohet vetëm një xhep ajri me lartësi të ulët. Dhoma e ajrit formohet duke ftohur vezën, e cila vendoset nga ana e polit me majë. Lëvozhga është gjysmë e përshkueshme, që do të thotë që ajri dhe lagështia mund të kalojë përmes poreve, filluska e ajrit do të rritet.

Detyra fillestare e dhomës së ajrit nuk përcaktimi i shkallës së freskisë së vezëve, por përkundrazi i shërben zogut si "furnizimi fillestar" me ajër derisa të çelë dhe të filloj të marrë frymë.

Si matet lartësia e dhomës së ajrit

Për të përcaktuar lartësinë e dhomës së ajrit kërkohet një burim i fortë drite. Drita mund të lidhet me makinat e klasifikimit dhe renditjes së vezëve. Për sasi të vogla vezësh ose edhe nga vetë konsumatorët mund të përdoret elektrik dore. Në një dhomë të errët vendoseni vezën mbi burimin e dritës, për të matur dhomën e ajrit, shablloni duhet të mbahet nga ana me majë e vezës, dhe më pas të lexohet lartësia e dhomës së ajrit.



Karakteristikat e cilësisë për vezët e kategorisë A

1) Vezët e kategorisë A kanë karakteristikat e mëposhtme të cilësisë:

- Lëvozhga dhe kutikula: e pastër, e padëmtuar, në formë normale
- Dhoma e ajrit: lartësia jo më e madhe se 6 mm, e palëvizshme; për vezët e tregtuara me emërtimin "Extra", lartësia nuk duhet të jetë më shumë se 4 mm
- E verdha e vezës: gjatë ndriçimit duket me hije, pa konture të qarta; gjatë rrotullimit të vezës nuk devijon ndjeshëm nga pozicioni qendror
- Albumina: e qartë, transparente

2) Vezët e kategorisë A nuk duhet të lahen ose pastrohen para ose pas klasifikimit

3) Vezët e kategorisë A nuk mund të ruhen ose të ftohen në dhoma ose ambiente me temperaturë të mbajtur artificialisht nën +5°C. Vezët nuk konsiderohen të ftohta nëse ato janë ruajtur në një temperaturë nën +5°C për maksimum 24 orë gjatë transportit ose në ambientet e shitjes për jo më shumë se 72 orë.

4) Vezët që nuk përmbushin karakteristikat e cilësisë sipas paragrafit 1, klasifikohen në kategorinë B.

Kriteret teknike për qendrat e ambalazhimit

Si qendër ambalazhimi mund të miratohen vetëm kompanitë që ndër të tjera kanë pajisjet teknike të nevojshme për trajtimin e duhur të vezëve:

- ♦ Një pajisje ndriçimi automatike ose me një person përgjegjës, për të mundësuar kontrollimin e cilësisë së secilës vezë.
- ♦ Një pajisje për përcaktimin e lartësisë së dhomës së ajrit.
- ♦ Një sistem për klasifikimin e vezëve sipas peshës.
- ♦ Një ose më shumë peshore të kalibruara për të peshuar vezët.
- ♦ Pajisje për shënjimin e vezëve.

Për më shumë informacion:



Q F Qendra e Formimit
P B Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

20. VEZËT E FSHATIT JANË NË MODË

Përpunuar nga Jon Zeneli

Rritja e tufave të vogla të pulave për vezë aktualisht ka fituar shumë e popullaritet dhe kërkesa për vezë nga pula të rritura në gjendje të lirë ose organike vazhdon të rritet. Kohët e fundit po ndërtohen gjithnjë e më shumë ambiente të vogla për vetëkonsum të vezëve, fikse ose të lëvizshme - deri në 350 pula - për shitje të drejtpërdrejtë të vezëve, p.sh. në bujtina, dyqane ushqimore dhe furra buke.

Raportimi, regjistrimi dhe vulosja e vezëve

Në parim, çdo fermë shpendësh, pavarësisht nëse është e madhe apo e vogël, duhet të raportohet/regjistrohet pranë autoriteteve përkatëse të zonës. Nëse vezët nga prodhimi personal shiten të pazgjedhura dhe pa specifikuar cilësinë dhe kategorinë e vezës, direkt nga ferma ose derë më derë direkt te konsumatori përfundimtar dhe shiten në sasi normale për konsum shtëpiak, atëherë vezët nuk duhet të vulosen.


Nga ana tjetër nëse vezët u shiten tregtarëve edhe në sasi të vogla është e nevojshme njohja si qendër paketimi dhe regjistrimi i pulës, për stampimin e vezëve duhet marrë kodi i prodhuesit.

Pulat për vezë rrjedhin nga pulat Bankiva të Azisë Jugore dhe Juglindore që jetojnë brenda dhe përreth bimësisë së dendur. Ato kanë ruajtur shumicën e sjelljeve të paraardhësve të tyre. Ashtu si pulat Bankiva flenë në pemë ose shkurre për të qenë të sigurt, edhe pulat për vezë duan të rrinë në purtekë. Purtekët duhet të vendosen në formë shkallës sipër rrjetës së plehut organik. Si rregull 20 cm për pulë, ku sipërfaqja e rrjetës së kutisë së plehut organik mund të llogaritet si një purtekë (1 m² sipërfaqja e rrjetës korrespondon me një gjatësi të purtekës prej 300 cm).



Përveç zonës së rrjetës, rekomandohet të vendosen ristela druri me gjatësi 15 deri në 20 cm për secilën pulë. Distanca e qartë midis dy nivele duhet të jetë 30 cm horizontalisht dhe 35 cm vertikalisht. Ristelat prej druri me skaje të rrumbullakosura, lartësia 3,5 deri në 4,0 cm dhe gjerësia 4,5 cm kanë dëshmuar vlerën e tyre. Në vend të tyre, rekomandohet përdorimi i dy ristelave druri të rrumbullakosura, 1,5 cm të gjera në një distancë prej 1,5 cm nga njëra-tjetra, sepse do të ishin më të buta për këmbët e pulave. Tubat metalikë shpesh bëhen shumë të rëshqitshëm dhe për këtë arsye nuk rekomandohen.

Rekomandime	
Zona e shfrytëzueshme (zona e jashtme e gërvishtjes, zonat e folesë, rrjetat, purtekët nuk përfshihen)	Max. 5 shpendë për m ²
Foleja	5 Pula për fole
Kuti pleh organik me rrjetë	Maksimumi 2/3 e sipërfaqes së stallës
Gjatësia e purtekëve	15 deri në 20 cm për pulë (përveç zonës së rrjetës)
Zona e gërvishtjes brenda kotecit	50 % e zonës së shfrytëzueshme të kotecit
Zona e gërvishtjes jashtë kotecit	50 % e zonës së shfrytëzueshme të kotecit



Kotecit duhet t'i shtohet një zonë e jashtme. Pulat kanë nevojë për gërvishtje dhe goditje, prandaj 1/3 e sipërfaqes së shfrytëzueshme të kotecit duhet të mbulohet me shtrojë në mënyrë që shpendët të plotësojnë këto nevoja themelore. Në hapësirat e vogla, kjo zonë për gërvishtje zakonisht mbulon gjysmën e zonës së përdorshme të kotecit. Gjithashtu pranë tij duhet të ngrihet një zonë tjetër e shtruar me të njëjtën madhësi si zona e gërvishtjes, por kjo nuk duhet të jetë e izoluar. Një zonë e tillë në natyrë u mundëson pulave të kryejnë aktivitete edhe në mot të keq. Zona e jashtme e gërvishtjes duhet të jetë plotësisht e izoluar nga lagështia për t'u mbrojtur nga gripi i shpendëve. Kjo vlen edhe për kotecet shumë të vogla. Sipërfaqja e dyshemesë së zonës së jashtme të gërvishtjes duhet të jetë e papërshkueshme nga lëngjet, në përputhje me ligjin dhe udhëzimet e OIB.

Rekomandohet një fole për maksimumi 5 pula me dy purtekë përpara. Para pjelljes së vezëve, pula ndahet nga grupi dhe në mëngjes kërkon folenë. Foletë, të cilat janë të shtruara me një shtrojë natyrore, duhet të ndahen nga pjesa tjetër e zonës së aktivitetit, të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të errësohen. Shtresa duhet të jetë rreth 6 cm e trashë.

Për më shumë informacion:



QF Qendra e Formimit
PB Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

21. REZISTENCA NDAJ ANTIBIOTIKËVE

Përpunuar nga Jon Zeneli

Antibiotikët për trajtimin e infeksioneve bakteriale janë ndër barnat më të përdorura në mbarë botën. Ekzistojnë lidhje të vërtetuara midis përdorimit të tyre dhe akumulimit të rezistencës antimikrobike: sa më shpesh të përdoren antibiotikët nga një grup i caktuar substancash te njerëzit ose kafshët, aq më shpesh gjenden më vonë patogjenë bakterialë që janë të pandjeshëm ndaj kësaj substance.

Për dekada antibiotikët janë përdorur për të trajtuar dhe parandaluar sëmundjet dhe infeksionet. Përdorimi i agjentëve antimikrobikë ka kontribuar shumë në përmirësimin e shëndetit të njerëzve dhe kafshëve. Antibiotikët janë të domosdoshëm në mjekësinë dhe procedurat moderne; transplantet, kimioterapia për kancerin apo kirurgjia ortopedike nuk mund të kryheshin pa përdorimin e tyre. Përdorimi i gjerë i tyre shoqërohet edhe me një rritje të shfaqjes së mikroorganizmave rezistente.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) zgjodhi temën "Rezistenca antimikrobike: asnjë veprim sot, jo shërim nesër" për Ditën Botërore të Shëndetit më 7 Prill 2011. Në vitin 2012, ministri e shëndetësisë të BE-së miratuan një deklaratë që theksonte se kjo rezistencë në rritje ndaj antibiotikëve është një problem i madh i shëndetit të njerëzve dhe kafshëve në Evropë dhe në mbarë botën, duke çuar në mundësi të kufizuara ose joadekuate trajtimi dhe duke ulur cilësinë e jetës.

Përdorimi i antibiotikëve në mjekësi

Në mjekësi, përdorimi i agjentëve antibakterialë për trajtimin e infeksioneve virale, përdorimi i pajustificuar i substancave me një spektër jashtëzakonisht të gjerë veprimi, përdorimi shumë i gjatë "profilaktik" i antibiotikëve në ndërhyrjet kirurgjikale dhe përdorimi i antibiotikëve thjesht për kolonizim (dhe jo infektion) i pacientëve konsiderohen si shkaktarët kryesorë të problemit të rezistencës. Gjithashtu, pacientët (në rastin e fëmijëve, prindërit e tyre) që kërkojnë trajtim kontribuojnë në keqpërdorimin e antibiotikëve.

Në Rekomandimin e Këshillit të datës 15 nëntor 2001 mbi përdorimin e kujdesshëm të antimikrobikëve në mjekësi,

shteteve anëtare iu kërkua të sigurojnë strategjitë specifike për përdorimin e kujdesshëm të antimikrobikëve, me synim kufizimin e rritjes së mikroorganizmave rezistente ndaj këtyre agjentëve. Përpjekjet për të reduktuar zhvillimin e rezistencës nëpërmjet përdorimit të arsyeshëm të antibiotikëve mund të gjenden në të gjithë Evropën. Ato synojnë kryesisht shmangien e përdorimit të antibiotikëve në trajtimin e infeksioneve virale. Fakti që diagnostifikimi mikrobiologjik i cilësisë së lartë nuk disponohet kudo në Austri e bën të vështirë për mjekun të bëjë dallimin e qartë midis infeksioneve që kërkojnë trajtim dhe atyre që nuk kërkojnë terapi antimikrobike; për më tepër, fillimisht mund të kryhet vetëm një terapi shumë e gjerë antimikrobike. Kjo rezulton në përdorimin e panevojshëm të antibiotikëve dhe përdorimin e preferuar të substancave me një spektër jashtëzakonisht të gjerë aktiviteti - të dy faktorë që nxisin zhvillimin e rezistencës ndaj antibiotikëve për shkak të presionit të natyrshëm të përzgjedhjes. Për shkak të përmirësimit të trajtimit të sëmundjeve virale, viruset rezistente ndaj ilaçeve po bëhen gjithashtu gjithnjë e më të rëndësishëm.

Në spitale, veçanërisht në repartet e kujdesit intensiv, mikrobet spitalore shumë-rezistente, janë tashmë një problem i përditshëm. Kombinimi i pacientëve të "dobësuar nga imuniteti", përdorimi intensiv dhe afatgjatë i antibiotikëve dhe transmetimi i mikrobeve nga pacienti në pacient çon në shfaqjen e infeksioneve me patogjenë shumë-rezistente, që nuk luftohen dot as me terapinë me antibiotikë.

Shumica e problemeve me rezistencën në mjekësinë humane lidhen jo vetëm me përdorimin e antimikrobikëve te njerëzit, por edhe me mënyrën e të ushyerit, ushqimit me origjinë shtazore. Paneli "Mbi Rreziqet Biologjike" (BIOHAZ) i Autoritetit Evropian të Sigurisë Ushqimore (EFSA) rekomandoi zhvillimin dhe zbatimin e masave specifike për të kontrolluar mishin e shpendëve, mishin e derrit dhe viçit që në vitin 2008, me prioritet masat për të luftuar rezistencën ndaj antibiotikëve. Në fushën veterinare, në Austri është kryer që nga viti 2004, monitorimi i detyrueshëm i prevalencës së zoonozave dhe patogjenëve të përzgjedhur zoonotikë si dhe ndjeshmërisë së tyre ndaj agjentëve antimikrobikë në popullatën blegtorale në Austri (në formën e kampionimit të rastësishëm për kafshët e therura të shëndetshme si viçat, derrat, shpendët).

OIE (Organizata Botërore për Shëndetin e Kafshëve) ka zhvilluar disa rekomandime për të luftuar rezistencën antimikrobike për të mbrojtur shëndetin e kafshëve dhe sigurinë ushqimore. Për sa i përket monitorimit të rezistencës ndaj antibiotikëve dhe regjistrimit të flukseve të vëllimit të antibiotikëve, ekzistojnë udhëzime për harmonizimin e programeve kombëtare, rekomandime për përdorimin e përgjegjshëm të antibiotikëve në mjekësinë veterinare dhe për vlerësimin e rrezikut të rezistencës ndaj antibiotikëve të kafshët, si dhe metodat laboratorike për zbulimin e rezistencës ndaj antibiotikëve.

Përdorimi i antibiotikëve në blegtori

Sipas ligjit për mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve, fermeri, nëse është e nevojshme është i detyruar të kërkojë ndihmë veterinare dhe të organizojë trajtimin e kafshëve të sëmurë. Infeksionet bakteriale trajtohen edhe me antibiotikë për të shmangur dëme më të mëdha ekonomike (humbje totale për shkak të ngordhjes së kafshës, humbje e përkohshme ose e përhershme e performancës, rrezik i përhapjes së sëmundjes në tufë ose edhe më gjerë në tufat e tjera dhe si rezultat rrezikimi i shëndetit të konsumatorëve).

Një veteriner duhet të përcaktojë nëse një infektion bakterial është i pranishëm. Në Austri, antibiotikët për trajtimin e kafshëve janë, pa përjashtim, ilaçe veterinare me recetë dhe përdorimi i tyre është i rezervuar për veterinerin. Si pjesë e një marrëdhënieje kujdesi në shërbimin shëndetësor të kafshëve, veterineri mund të udhëzojë fermerin për përdorimin e barnave dhe vaksinave të ndryshme.

Gjithashtu antibiotikët përdoren për të parandaluar përhapjen e infeksioneve bakteriale. Shembuj të përdorimit të tillë të antibiotikëve janë, trajtimi i njëkohshëm i kafshëve të prekura ose jo, por ndoshta të infektuara në një tufë ose grup kafshësh.

Sipas rregullores organike të BE-së, veterineri mund të përdorë të gjitha barnat veterinare në një fermë organike. Nëse është e nevojshme, antibiotikët mund të përdoren edhe për mjekim, por si rezultat, periudha ligjore e tërheqjes (koha nga administrimi i fundit i një bari tek një kafshë deri në momentin kur prodhohet ushqimi nga ajo kafshë) duhet të dyfishohet. Frekuenca e trajtimeve është e kufizuar për kafshët organike. Kafshët që jetojnë më pak se një vit mund të trajtohen maksimumi një herë. Të gjitha kafshët e tjera mund të marrin maksimum tre trajtime me antibiotikë brenda një viti.

Masat parandaluese mund të zvogëlojnë infeksionet bakteriale dhe si pasojë përdorimin e antibiotikëve. Nga njëra anë, këtu përfshihet optimizimi i blegtorisë (ndërtimi i stallave, klima e qëndrueshme), optimizimi i menaxhimit (stoqet e mbyllura të kafshëve, masat higjienike, etj.), por edhe vaksinimet.

Rezistenca antimikrobike te bagëtitë

Në përputhje me Direktivën e BE-së 2003/99/EG, Ministria Federale e Shëndetësisë në Austri, së bashku me Agjencinë për Shëndetin dhe Sigurinë Ushqimore (AGES) dhe veterinerët e terrenit, ka zhvilluar programe vjetore monitorimi për popullata të ndryshme të kafshëve që nga viti 2004, për të përcaktuar prevalencën dhe ndjeshmërinë antimikrobike të disa patogjenëve zoonotikë dhe baktereve tregues.

Në Austri, aktualisht janë miratuar për përdorim në blegtori 305 produkte medicinale veterinare, të cilat përmbajnë substancat e mëposhtme antibiotike: aminoglikozide, ansamicinë-rifamicinë, cefalosporina të gjeneratës së parë dhe të dytë, cefalosporina të gjeneratës 3 dhe 4, linkosamide, makrolide, penicilina, polikolmiksina, amphenikolmi, pleuromutilina, fluorokinolone, sulfonamide, sulfonamide + trimetoprim, tetraciklina.

Autoriteti mbikëqyrës i tregut mjekësor AGES kontrollon efikasitetin, sigurinë dhe cilësinë e barit dhe vendos për miratimin ose zgjatjen e miratimit bazuar në profilin e përfitimit-risk. Do të ndërmerret një rishikim i thellë i efikasitetit dhe sigurisë, duke përfshirë shëndetin e njerëzve dhe kafshëve dhe rreziqet mjedisore që mund të paraqesin rezistenca bakteriale.

Në pesë vitet e fundit, më shumë se 80 produkteve medicinale antimikrobale veterinare për bagëti u janë tërhequr miratimet për arsye të tilla si mungesa e efikasitetit të kombinuar me rrezikun e lartë të përhapjes së rezistencës, kombinime të vjetëruara të përbërësve aktivë ose defekte prodhuese (cilësi), si për arsye ekonomike.

Vëllimet e shitjeve të antibiotikëve në mjekësinë veterinare në Austri në 2015


Në mjekësinë veterinare, u shitën 48,78 ton antibiotikë në Austri në vitin 2015. Krahasuar me vitin 2014, ka patur një rënie të ndjeshme të vëllimit total të shitur me rreth 4.89 tonë. Kjo korrespondon me një rënie relative prej rreth 9.1%.

Për të regjistruar të dhënat për një vit, jo vetëm kompanitë farmaceutike dhe shitësit me shumicë, por edhe veterinerët që drejtojnë farmacitë e vogla, duhet të ngarkojnë të dhënat e tyre direkt në bazën e të dhënave nëpërmjet faqes së internetit të Autoritetit të Tregut Mjekësor AGES. Tani për herë të parë, është e mundur që të ndahet sasia e substancave aktive antimikrobiale për speciet individuale të kafshëve. Rreth 75.8% e antibiotikëve janë përdorur nga derrat, rreth 17% nga gjedhët dhe 6.8% nga shpendët.

Përdorimi i antibiotikëve në shpendët – Zhvillimet 2008-2015

Përdorimi i antibiotikëve në industrinë e shpendëve, bazuar në të dhënat e disponueshme nga të dhënat e shëndetit të shpendëve të OGV mund të vlerësohet si pozitiv. Siç tregon grafiku, në 2013-2015 gjelat panë një rënie të qëndrueshme të konsumit AB. Konsumi AB te gjelat tregon një reduktim të mëtejshëm prej 280 kg nga 2014 në 2015.

Për broilerat, rënia nga 2012 në 2013 është 450 kg (0,45 t kolona jeshile) dhe nga 2013 në 2014 170 kg të tjera (0,17 t). Nga viti 2014 deri në vitin 2015, mund të vërehet një rritje e lehtë prej 200 kg (0.20 t) në një nivel tashmë të ulët. Pulat për vezë janë të vetmet specie shpendësh ku përdorimi i antibiotikëve është rritur vitet e fundit. Kjo rritje mund të shpjegohet me kalimin në forma alternative të mbarështimit, si p.sh. në sisteme të lira. Infektimi me parazitë është më i lartë, që do të thotë se rritet numri i sëmundjeve ngjitëse, si rezultat kafshët duhet të trajtohen me antibiotikë (në grafik kolona portokalli).




Zhvillimet 2008-2015

Nëse merret parasysh përdorimi dhe konsumi i antibiotikëve në të gjithë sektorët e shpendëve së bashku, mund të regjistrohet një reduktim total prej 2,14 t antibiotikësh, bazuar në sasinë e përbërësit aktiv, gjatë periudhës 2011-2015.

Kjo paraqet një rënie të përdorimit të antibiotikëve prej 45% që nga viti 2011.

Sasia e përbërësit aktiv në ton



Masat për mitigimin e antibiotikëve në blegtori

Regjistrimi efikas i konsumit të barnave (të rekomanduara nga veterineri) nga fermat individuale, i stokut të kafshëve të trajtuara dhe sasia e barnave, i cili mundëson vlerësime krahasuese.

Masat e synuara individuale të fermës për të rregulluar përdorimin e "antibiotikëve rezervë"

- nuk ka tregti të lirë me barna, por lidhja e furnizimit me barna veterinare me trajtimin e duhur.
- lidhje e ngushtë kohore e dhënies së barit me diagnozën dhe këshillimin nga veterineri,
- kontrolli i aplikimit dhe suksesi i trajtimit.

Menaxhimi aktiv i shëndetit për të reduktuar përdorimin e antibiotikëve:

- përmirësimi i kushteve të blegtorisë dhe të ushqyerit.
- profilaksia e synuar imune.
- përdorimi i produkteve alternative (p.sh. ushqimi suplementar).
- kualifikimi i vazhdueshëm i stafit bujqësor si pjesë e menaxhimit të integruar të stokut.

Me Planin Kombëtar të Veprimit për Rezistencën Antimikrobike (NAP-AMR) dhe Raportin Austriak të Rezistencës Antimikrobike AURES, Ministria Federale e Shëndetësisë në mjekësinë njerëzore dhe atëveterinare po ndjek një koncept të përbashkët për mitigimin e rezistencës antimikrobike. Udhëzimet për trajtimin e kujdesshëm me produkte medicinale veterinare antibakteriale, zbatohen për trajtimin e sëmundjeve bakteriale tek kafshët e fermës, si dhe tek kafshët individuale, të vogla dhe kafshët shtëpiake. Që nga viti 2015, zbatimi i Normës së Flukseve të Vëllimit të Antibiotikëve (Fletorja e Ligjit Federal 11 Nr. 83/2014) ka shërbyer për regjistrimin e saktë të konsumit të antibiotikëve në blegtori, ato të shitura nga kompanitë, si dhe pas vitit 2016 edhe ato të dorëzuara nga veterinerët.

Mikrobet rezistente në ushqim

Sipas udhëzimeve të Shoqatës Gjermane për Higjienën dhe Mikrobiologjinë, lejohen deri në 5 milionë mikrobe për çdo gram mish shpendësh. Numri më i lartë i mikrobeve është gjithashtu i mundur me mishin që maturohet më gjatë. Disa nga këto mikrobe gjithashtu mund të jenë rezistente ndaj disa antibiotikëve.

Gjatë prodhimit, përgatitjes dhe konsumit të ushqimit, mikrobet rezistente mund të transmetohen te njerëzit nëpërmjet tij. Nëse një person merr mikrobe rezistente përmes ushqimit dhe këto mikrobe i mbijetojnë kalimit në stomak, ata mund të kolonizojnë zorrët për një kohë të caktuar. Në shumicën e rasteve nuk ka infeksion. Megjithatë, nëse këto mikrobe hyjnë në zona të tjera të trupit (p.sh. përmes operacioneve), ato mund të shkaktojnë sëmundje, ashtu si mikrobet jo rezistente.

Mikrobet rezistente nuk janë më patogjenë sesa mikrobet që janë të ndjeshëm ndaj antibiotikëve. Kjo do të thotë se ata nuk kanë më shumë gjasa të shkaktojnë infeksione, por kur ndodh një infeksion, ka më pak antibiotikë në dispozicion për t'i trajtuar ato.

Pavarësisht nëse mikrobet janë rezistente apo jo, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet ruajtjes dhe përgatitjes së duhur gjatë trajtimit të ushqimeve të papërpunuara të kafshëve:

- Në rastin e ushqimeve shtazore të papërpunuara, sigurohuni që kohët e transportit të jenë të shkurtra ose të ruhen në frigorifer pas blerjes
- Ruajtja e duhur në shtëpi (temperatura e frigoriferit nën 5 °C)
- Mishi, peshku i papërpunuar dhe prodhimet e detit të papërpunuara nuk duhet të kenë asnjë kontakt me ushqimet të tjera
- Gjithmonë lani duart pas trajtimit të ushqimit të papërpunuar
- Enët dhe pajisjet e përdorura me ushqim të papërpunuar nuk duhet të vijnë në kontakt me ushqimin e gatshëm
- Gatim i plotë - Kjo vret në mënyrë të besueshme mikroorganizmat (përfshirë ato rezistente).

Monitorimi i situatës së rezistencës në Austri dhe Evropë.

Mikrobet rezistente mund të gjenden në mjedis, te kafshët, te ushqimi dhe te njerëzit. Situata e rezistencës ndaj antibiotikëve dhe konsumit të substancave antimikrobiale në sektorin njerëzor, veterinar dhe ushqimor në Austri është publikuar çdo vit që nga viti 2005 në Raportin Austriak të Rezistencës Antimikrobike (AURES).

AGES ka qendra referimi për mbikëqyrjen epidemiologjike të sëmundjeve infektive ngjitëse dhe jo të transmetueshme. Përveç përcaktimit dhe tipizimit të patogjenëve, regjistrohet edhe rezistenca ndaj antibiotikëve. Rezultatet e këtij hetimi rrjedhin në raportin e AURES dhe publikohen në raportet vjetore.

Bakteret te njerëzit, kafshët dhe ushqimet vazhdojnë të demonstrojnë rezistencë ndaj antimikrobialëve më të përdorur, sipas raportit të fundit mbi rezistencën ndaj antibiotikëve në bakteret zoonotike në Evropë.

Rritja e rezistencës së patogjenëve njerëzorë ndaj antibiotikëve është një problem sot, i cili kërkon që të gjitha fushat e përfshira (mjekësia njerëzore, mjekësia veterinarë, prodhimi primar i kafshëve, përpunimi dhe përgatitja e ushqimit, konsumatorët) të jenë të gatshëm të marrin përgjegjësinë në sektorin e tyre përkatës të veprimtarisë.

Për më shumë informacion:



**Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve**

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

22. MASAT PARANDALUESE KUNDËR INSEKTEVE NË STALLË

Përpunuar nga Jon Zeneli

Rritja e shfaqjes së insekteve (mizave) përbën një shqetësim masiv për kapanonet e pulave. Si mund të luftohen me sukses insektet e bezdisshme?

Nëse fermeri reagon shumë vonë, do të jetë krijuar një popullatë e konsoliduar insektesh, sepse potenciali i tyre i zhvillimit është i jashtëzakonshëm. Shpesh sistemet individuale të stallave ofrojnë kushte optimale për mizat, prandaj masat emergjente kanë vetëm sukses afatshkurtër ose, në rastin më të keq, nuk kanë fare efekt.

Për të luftuar me sukses mizat në kapanonet e pulave, duhet të merren parasysh karakteristikat e sistemeve të ndryshme të mbarështimit të pulave. Masat e kontrollit dhe frenimit, të përshtatura për sistemet përkatëse kanë një ndikim të rëndësishëm, zvogëlojnë përpjekjet dhe parandalojnë rritjen e kostove në kontekstin e luftimit të mizave.

Për të ndërprerë me sukses një përhapje shpërthyesë të mizave, kërkohen të merren masa sistematike. Faktori vendimtar për kontrollin gjithëpërfshirës të mizave nuk është eliminimi afatshkurtër i mizave të sapo shfaqura, por qasja paralele dhe e synuar ndaj ciklit të përhapjes së insekteve. Për shembull, glasat e shpendëve janë burimi më i mirë i mundshëm i ushqimit për mizat duke ofruar edhe kushte optimale të zhvillimit të larvave.

Si rrjedhim, gjendja dhe manipulueshmëria e plehut organik të shpendëve kanë një ndikim të rëndësishëm në përshtatshmërinë e tij si një habitat për mizat.

Sistemet e stallës me akumulimin e vazhdueshëm të plehut, tipike për gropën e plehut, në rastin më të keq, mund të shërbejnë si një terren mbarështues gjatë gjithë vitit për mizat. Nga ana tjetër, në stallat me heqje mekanike, pjesa më e madhe transportohet rregullisht në gropën e jashtme të plehut. Sistemet që sigurojnë heqjen e rregullt mekanike të plehut organik në intervale të shkurta e bëjnë më të lehtë frenimin e zhvillimit të mizave në gropat e plehut.

Lagështia e plehut është gjithashtu një faktor që mund të ndikojë në mënyrë specifike. Plehu i thatë e bën më të vështirë zhvillimin e larvave të mizave, kështu që çdo depërtim i ujit të rrjedhshëm në gropën e jashtme të plehut organik duhet të parandalohet sa më shpejt që të jetë e mundur. Mizat gjithashtu tërhiqen masivisht nga aromat e kompostit gjatë procesit të dekompozimit. Kjo vlen për gropën e plehut organik si dhe për ato të ushqimit. Gjithashtu duhet të parandalohet çdo akumulim i mbetjeve të ushqimit dhe/ose lagështisë në sillos.

Shpesh sillosat vendosen në dhoma të mbrojtura, direkt në ndërtesën e stallës, gjë që ka një efekt tërheqës për mizat dhe që nuk duhet nënvlerësuar. Kjo intensifikohet më tej nga mbetjet e ushqimit, që ndodhin gjatë ngarkimit të tij, si dhe kur lagështia është e pranishme.

Luftimi

Zhvillimi i mizave mund të ndalohet në kohën e duhur nga aplikimi i rregullt i larvicideve agrokimike ose nga përdorimi i synuar i grerëzave të dobishme si parazitoide në larvat e mizës. Një kombinim i larvicideve dhe grerëzave parazitare nuk duhet të përdoret, pasi larvat e grerëzave parazitare do të asgjësoheshin në të njëjtën kohë. Përdorimi i larvicideve kërkon një nivel të lartë ndërgjegjësimit nga ana e çdo menaxheri ferme. Përveç kësaj, ky trajtim duhet të kryhet disa javë përpara shfaqjes së mizave të rritura. Kur përdoren grerëza parazitare, është thelbësore, në varësi të stinës dhe kushteve të motit, të lëshohen sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë të përsëritur në të gjithë stallën.

Si një masë shtesë për të kontrolluar mizat janë të dobishëm edhe vrasësit e insekteve UV të disponueshëm në treg. Ata mund të përdoren edhe për të vlerësuar nëse ka më shumë miza. Në zonat e jashtme, gjatë muajve të ngrohtë përdoren edhe kurthet e karremit. Efekti i tyre fort tërheqës, mund të shkaktojë shqetësim në ambientet e përditshmërisë në punë, prandaj këshillohet që të vendosen diku larg tyre.



Madje edhe sasi të më të vogla të mbetjeve organike shtëpiake në kopsht janë të mjaftueshme për t'u konsideruar si një terren mbarështues me një efekt tërheqës për mizat. Duhet të merren parasysh gjithashtu grumbujt e kompostit dhe plehut organik që nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me mbarështimin e pulave.

Mbarështuesit e pulave duhet të jenë mjaft vigjilentë ndaj kësaj specijeje të vogël, por me një impakt të madh, duke marrë masa dhe reaguuar sa nuk është vonë.

Për më shumë informacion:



Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

23. BLEGTORIA E ORIENTUAR DREJT PERFORMANCËS FILLON ME NJË HIGJIENË TË QËNDRUESHME TË STALLËS

Përpunuar nga Kristian Maka

Higjiena zakonisht kushton më pak se sa dëmi, prandaj duhet vepruar përpara se kafshët të sëmuren. Pastrimi dhe dezinfektimi i stallës janë masa të rëndësishme parandaluese.

Kushtet e mbarështimit të kafshëve të fermës kanë ndryshuar, për shkak të risive teknologjike. Në të njëjtën kohë, ky zhvillim sjell me vete edhe ndryshime, që lidhen me sëmundjet, të cilat prekin sot kafshët: dikur mbizotëronin sëmundjet e shkaktuara nga parazitët dhe bakteret, sëmundjet e lidhura me viruset po shfaqen tani më gjithnjë e më shumë.

Kohët e fundit është folur shumë për "gripin misterioz të derrit", që po përhapet në mënyrë shpërthyesë në vende të ndryshme si Westfalen, Weser-Ems dhe Hollandë. Ka të dhëna se kjo sëmundje nuk ndalet në stallën e majmërisë, ajo mund të transmetohet nëpërmjet kafshëve të blera ose nga minjtë.

Mbrojtja

Masat e duhura higjienike mund të ndërpresin rrugët dhe zinxhirët e infeksionit. Kjo përfshin pastrimin dhe dezinfektimin e plotë, me produkte nga Schaumann, me performancë të lartë dhe eco-friendly me mjedisin, të cilat kombinojnë kosto-efektivitetin dhe sigurinë për prodhuesin. Përdorimi i dezinfektantëve me presion të lartë kursen gjithashtu kohë dhe para.

Fig. 1: Udhëzimet për masat higjienike

Parimi
Fillimisht pastrim, më pas dezinfektim
Principi
Pastrim + Dezinfektim = Higjiena e prodhimit
Rezultati
Higjiena e prodhimit siguron suksesin

Pastrimi

Sistemimi i stallës është hapi që i paraprin pastrimit. Pajisjet e lëvizshme duhet të hiqen dhe të trajtohen veçmas. Stalla duhet të fshihet mirë. Vijohet me heqjen e papastërtive të ngurta me shpatull, hap i cili ndihmon në kursimin e ujit dhe zvogëlimin e përmbajtjes së ujit në plehun organik. Të gjitha sistemet elektrike të panevojshme, gjatë pastrimit duhet të fiken.

Pastrim i duhur do të thotë:

- ♦ Lagia (1-1,5 l ujë/m², përafërsisht 3 orë)
- ♦ Pastrimi (13-15 l ujë/min në 40 °C)
- ♦ Tharja

Për të rritur efektin, ujit (rreth 40 °C) i shtohet një agjent pastrues (agjent pastrimi i lëngshëm).

Pastrimi:

- ♦ largon mikrobet që përmbajnë papastërtitë
- ♦ largon mikrobet e sipërfaqes nga shtresa e tyre mbrojtëse
- ♦ pakësohet lidhja e padëshiruar e dezinfektuesit me papastërtitë

Pastruesi me presion të lartë përdoret deri në momentin që sipërfaqja fillestare e objekteve që do të pastrohen, të dallohet qartë dhe uji i shpëlarjes të jetë i pastër nga grimcat e papastërtive.

Dezinfektimi nuk fillon direkt pas pastrimit. Uji i mbetur duhet të hiqet nga pirëset e ujit, logu i ushqimit etj, sepse shkakton hollim të tretësirës dezinfektuese gjatë procesit pasues të dezinfektimit. Ventilimi siguron një tharje më të shpejtë.

Dezinfektimi

Dezinfektimi fillon me zgjedhjen e dezinfektuesit të duhur. Produkte të tilla si ORGANOSEPT dhe ENDOSAN janë testuar dhe përfshihen në listën e dezinfektuesve të Shoqatës Gjermane Veterinare (DVG).

Dezinfektimi i duhur do të thotë:

- ♦ Zgjedhja e dezinfektantit të duhur
- ♦ Aplikimi në përqendrim optimal
- ♦ Koha optimale e veprimit

Dezinfektimi kundër mikrobeve patogjene në stallë (Fig. 2).



Fig. 2: Një shembull i efikasitetit të dezinfektimit





Fig. 3: Numri i bakterieve në 1 cm² sipërfaqe të stallës, para dhe pas larjes/dezinfektimit

Temperatura është gjithashtu e rëndësishme. Dezinfektuesit testohen në rreth 20°C. Rregulli i përgjithshëm është: temperaturat më të larta përmirësojnë efektin - temperaturat më të ulëta zvogëlojnë efektin, veçanërisht me aldehidet. Tretësira duhet të përgatitet sipas udhëzimeve të përdorimit, si rregull, 0,4 L tretësirë e gatshme për përdorim për m² përdoret për të arritur efektin e plotë të dezinfektimit. Aplikimi i duhur kryhet me një spërkatës shpine ose me një pastrues me presion të lartë.

Gjatë dezinfektimit, kur stallat janë bosh, dyert dhe dritaret duhet të jenë të mbyllura dhe ventilimi i fikur. Mbetjet e dezinfektuesit duhet të hiqen nga pirëset e ujit dhe pajisjet e ushqimit, pasi të ketë kaluar koha e veprimit dhe përpara se stalla të rimbushet.

Në kushte normale, përdoret dezinfektimi parandalues, i cili synon të reduktojë përmbajtjen e mikrobeve në rreth 100 deri në 1000 mikrobe/m² pas një periudhe mbarështimi dhe para instalimit të ri (Figurën 3). Eksperienca ka treguar se në këtë mënyrë mikrobet problematike reduktohen ndjeshëm.

Stallat bosh duhet të dezinfektohen plotësisht (parimi brenda-jashtë). Në çdo rast, duhet të kryhet një dezinfektim i pjesshëm ose një dezinfektim me qarkullim i njëjësive të stallave bosh.



Problemimet

Ventilimi është një problem i veçantë gjatë pastrimit dhe dezinfektimit. Vështirësitë lindin për shkak të strukturave të sistemeve të ventilimit. Boshtet e ventilimit mbartin rrezikun e futjes në stallë të mikrobeve në rast se kondensohet uji i kontaminuar, kështu zinxhiri i transmetimit nuk mund të ndërpritet. Sistemi i ventilimit duhet të jetë i aksesueshëm për pastrim dhe dezinfektim.

Sistemet stallore me dysheme kanë disavantazhin se në pjesën e poshtme nuk pastrohen dhe dezinfektohen mjaftueshëm dhe patogjenët mbijetojnë. Ata p.sh. mund të rikthehen në sipërfaqen e stallës nga të çarat e zgarave të betonit.

Për më shumë informacion:



**Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve**

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

24. SCHAUMACID NË USHQIMIN E SHPENDËVE – PERFORMANCË MË E LARTË

Përpunuar nga Kristian Maka



Cilësia e ushqimit është një nga faktorët më të rëndësishëm për mbarësitimin e suksesshëm të pulave për vezë dhe mish. Furnizimi i duhur me lëndë ushqyese, minerale, vitamina si dhe substanca të tjera aktive në të gjitha periudhat e prodhimit luan një rol të rëndësishëm për suksesin ekonomik. Në të njëjtën kohë, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet higjienës në furnizimin me ujë dhe racioneve ushqimore. Përdorimi i SchaumaCid në ujin e pijshëm dhe në racionet ushqimore ka rezultuar i suksesshëm në teste të ndryshme si dhe në praktikë.

Uji është thelbësor për jetën dhe është një nga lëndët ushqyese kryesore në ushqimin e shpendëve. Nëse nuk ka ujë mjaftueshëm në dispozicion, shpendët gjithmonë do të përshtaten me këtë situatë, por me performancë të keqe dhe prodhimi të ulët.

Cilësia e ujit të pijshëm luan një rol vendimtar. Në kushte normale në stallë, ka terrene të shkëlqyera për mikrobet e dëmshme si salmonela ose bakteret koliforme. Temperaturat, lagështia dhe vlera e pH janë në intervalin optimal për shumimin e mikrobeve. Përveç kësaj, konsumohet dukshëm më shumë ujë sesa ushqim dhe efekti i një patogjeni varet shumë nga sasia e konsumuar.

Ujë i pijshëm i një cilësie të lartë

Për të përmbushur kërkesat për ujë të pijshëm të një cilësie të lartë, përdorimi i kombinimit acid SchaumaCid ka rezultuar i suksesshëm.

Studimet në institutin mësimor dhe kërkimor në Kitzingen si dhe përvoja e fermave të mëdha të shpendëve mbështesin efektet pozitive të SchaumaCid.

SchaumaCid është një kombinim i disa acideve organike që përputhen në mënyrë optimale me njëri-tjetrin - garantojnë efektin antibakterial. Vlera e pH e ujit të pijshëm do të ulët, gjë që pengon rritjen e mikrobeve në ujë. Shkaktarët kryesorë të sëmundjeve diarrike - koliformet dhe salmonelat - kufizohen në zhvillimin e tyre dhe e gjithë flora e zorrëve stabilizohet.

Përdorimi i kombinimit të acidit tregon një gjendje shumë të lartë shëndetësore, si dhe një nivel të qëndrueshëm dhe të lartë të performancës së shpendëve.


Përdorimi dhe dozimi

Aplikimi i SchaumaCid bëhet çdo dy ditë, në varësi të presionit të mikrobeve për 12 deri në 24 orë, nëpërmjet shpërndarësit të ilaçeve. Dozat e mëposhtme përdoren për majmërinë e zogjve:

- nga java e dytë e majmërisë 0,05 %
- nga java e tretë e majmërisë 0,1 %
- nga java e katërt e majmërisë 0,15%
- nga java e pestë e majmërisë 0,2 %

Nga java e dytë e jetës, gjelat marrin me ujin e tyre të pijshëm 0,05% SchaumaCid të lëngshëm. Më pas doza rritet çdo 3 deri në 4 javë, deri në maksimum 0,2%, gjithmonë në varësi të konsistencës së feçeve.

Dozimi i lëngut SchaumaCid është shumë i lehtë (Fig. 1). Pompa me membranë magnetike e montuar jashtë thith acidin direkt nga fuçia e acidit ose rezervuari i ruajtjes së ilaçeve dhe e pompon atë në sistemin e ujit të pijshëm nëpërmjet një valvule injektimi.



Përshkrimi i produktit: Matësi i instaluar në linjën e ujit të pijshëm i jep një impuls pompës së dozimit. Në varësi të preferencave, kjo mund të dozojë sasi të ndryshme (zakonisht 0,1%) në një pikë mbyllëse në tubin e ujit.

Avantazhi i këtij sistemi: jetë e gjatë shërbimi, kosto të ulëta mirëmbajtjeje (membranë e vogël), shpejtësi e lartë e rrjedhës së ujit, instalim i thjeshtë

Dozimi bëhet nëpërmjet një matësi që kontrollon pompën. Pajisjet ekzistuese për dozimin e ilaçeve ose vitaminave, përpara përdorimit duhet të kontrollohen për rezistencë ndaj acidit.

Konvertim më i mirë i ushqimit

SchaumaCid gjithashtu ka dëshmuar për vlerat e tij edhe në përbërjen e racionit dhe çon në një stabilizim të përzierjeve të ushqimit. Rritja e mikroorganizmave zvogëlohet, arrihet një kufizim afatgjatë dhe efektiv i mikrobeve të padëshiruara, sistemi tretës i shpendëve stabilizohet dhe lëndët ushqyese të disponueshme përdoren në mënyrë efektive.

Furnizimi me proteina tregon një aktivitet të shtuar të enzimave të ndarjes së proteinave (pepsinogjen) dhe si pasojë një përdorim të optimizuar të fraksionit të proteinave. Ekziston gjithashtu një mënyrë e përmirësuar e veprimit të aditivëve të fitazës dhe promovimi i përthithjes së mineraleve. Këto veti pozitive gjithëpërfshirëse tregojnë avantazhet ekonomike të përdorimit të SchaumaCid.

Rezultatet praktike dhe testet në Kitzingen konfirmojnë avantazhet e përdorimit të acidit, i cili përveç stabilizimit të të gjithë florës së zorrëve, optimizon edhe konvertimin e ushqimit. Shpendët kanë shëndet më të qëndrueshëm dhe shtroja është më e thatë. Gjithashtu, vihet re një ulje e ndjeshme e ngordhshmërisë dhe një përmirësim i dukshëm i performancës. Kjo është mënyra se si SchaumaCid mbështet rritjen e shpendëve, të sigurt dhe me rentabilitet të lartë.

Shtesat e larta ditore në majmërinë e shpendëve dhe një përmirësim në konvertimin e ushqimit si në majmëri ashtu edhe te pulat për vezë tregojnë se duke përdorur Schauma-Cid mund të arrihen rezultate ekonomike pozitive në çdo fermë.

Për më shumë informacion:



**Qendra e Formimit
Profesional të Blegtorëve**

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

25. CILËSIA E LARTË E UJIT TË PIJSHËM REZULTON EFEKTIVE

Përpunuar nga Kristian Maka



Dy produkte speciale me përdorim në ujin e pijshëm mbështesin vitalitetin dhe rritjen e rendimentit në mbarështimin e shpendëve.

SchaumaCid - një kombinim i acideve organike për të gjitha fazat e mbarështimit të shpendëve - kontrollon në mënyrë efektive praninë e mikrobeve të dëmshme si p.sh. E. Coli dhe Salmonela. Bakteret e dobishme promovohen dhe rreziku i diarresë zvogëlohet ndjeshëm, si pasojë e një flore të qëndrueshme gastrointestinale. Vitamina C forcon sistemin imunitar të kafshëve - veçanërisht e rëndësishme në kohë stresi.

Kombinimi i acideve organike me Ligno Sulfonate redukton vetitë agresive duke ruajtur efektin acid. Shpejtësia e avullimit, aroma dhe konsumimi i materialit janë ulur ndjeshëm. Pija SchaumaCid përdoret deri në 0.2% në ujin e pijshëm.

Ovilac WA u zhvillua posaçërisht për zogjtë e majmërisë. Përveç probiotikut të aprovuar Bonvital, efektive janë edhe vitaminat D3, E dhe C. Shëndeti i kafshëve stabilizohet, ulet ndjeshmëria ndaj stresit dhe rritet rezistenca ndaj sëmundjeve infektive.

Një biofilm i ofron mukozës së zorrëve, mbrojtje të veçantë dhe kolonizimi me mikrobe të dëmshme reduktohet ndjeshëm.

Rezultati: kafshë vitale me parametra të përmirësuar të performancës, zhvillim të peshës trupore, konsum të ushqimit, si dhe ndjeshmëri të reduktuar ndaj stresit.

Ovilac WA përdoret me 100 mg/I ujë nëpërmjet një dozuesi mjekimi me pompë qarkullimi ose përzierës. Në faza stresi ose pas përdorimit të ilageve, sasia mund të rritet në 200 mg/I ujë.

Për më shumë informacion:



Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al

26. GJELA DETI TË SHËNDETSHËM DHE TË FUQISHËM - SUKSES I GARANTUAR ME PRODUKTET SCHAUMANN!

Përpunuar nga Kristian Maka

Produktet Schaumann për gjelat e detit janë të aprovuara në institutin mësimor dhe kërkimor për mbarështimin e kafshëve të vogla në Kitzingen. Performanca e 1000 zogave (Big 6) u kontrollua në një majmëri 4-fazore. Të gjitha përzierjet bazoheshin në miellin e sojës HP, sojën me yndyrë të plotë, misrin, grurin, vajin e sojës dhe përzierjen minerale për gjelat e detit Schaumann. Përbërësit e analizuar për 4 përzierje tregohen në figurën 1.

Fig. 1:

		Starter Java 1-5	Faza II Java 6-10	Faza III Java 11-14	Faza IV Java 15-17
Proteinë e papërpunuar	g	294	235	225	190
ME	MJ	12,1	12,9	13,3	13,9
Metioninë	g	6,5	5,0	4,6	4,0
Lizinë	g	18,6	14,9	12,5	10,5
Ca	g	15,5	13,0	10,0	9,0
P	g	10,0	8,5	8,4	7,5

Një kokcidiostat dhe një antihistaminë u shtuan në recetën ushqimore të fazës F1 (starter) dhe të fazës F2. Gjatë gjithë periudhës së majmërisë, kontrolli i vazhdueshëm i feçeve nuk zbuloi shenja të infektimit me oocista kokcidiake. Shëndeti i shpendëve u reflektua edhe në humbjet, të cilat ishin jashtëzakonisht të vogla, shkuan maksimumi në vetëm 0.9% gjatë gjithë periudhës së majmërisë. Të dhëna të mëtejshme të performancës janë renditur në Figurën 2. Rezultate jashtëzakonisht të mira janë marrë për ushqimin e grimtuar, i cili konsumohet më pak se ai i peletuar.

Fig. 2: Performanca e majmërisë

		Starter Java 5	Faza II Java 6-10	Faza III Java 11-14	Faza IV Java 15-17	E gjithë periudha e majmërisë
Pesha trupore	kg	1,38	5,0	8,54	10,15	10,15
Shtimi	kg	1,32	3,62	3,54	1,61	10,09
Konsum ushqimi	kg	2,10	7,78	11,33	8,29	29,52
Konvertimi i ushqimit	kg/kg	1,63	2,14	3,0	5,17	2,88
Humbjet	%	0,4	0,0	0,5	0,0	0,9

Therja e 80.6% e pulave Big 6 rezultoi në një peshë therjeje prej 8.23 kg. Kapaciteti i lartë i shpendëve për të shtuar peshë u konfirmua plotësisht.

Efekti pozitiv i Schaumann-Puten-Mineral me rezultate shumë të mira është konfirmuar sërish!

Përbërësi i ri aktiv i Schaumann Herbamin, stimulon marrjen e ushqimit dhe siguron një mjedis optimal të zorrëve. Rezultati është: shpendë me rritje të shëndetshme!

Për më shumë informacion:



Qendra e Formimit Profesional të Blegtorëve

Austria Praemix shpk

Tel: +355 (0)68 402 6311

e-mail: agri@ap.com.al

website: www.ap.com.al